

THESARE

MJET FRYMËZIMI DHE UDHËRRËFYES PËR PASTORËT DHE SHËRBYESIT

numri 4 / pranverë 2015

Editorial 2
Gëzim Spahija

Armatimi i Perëndisë 3
George O. Wood

Kujdes nga Gjambat e Satanit 8
Stephen Lim

**Beteja e Ideve, Koncepteve
dhe Mendimeve** 14
Paul Alexander

**Botëkuptime dhe Bota
e Padukshme** 20
Terry Hanna

**Të Sjellim Ndikim mbi Komunitetet
ku Jetojmë për Lavdinë e Krishtit** 26
Fatjon Kadiu

Dhelprat e Vogla 28
Marcia Lednicky

Përvijim Predikimi 34
Kurt Plagenhoef

Tema e këtij numri:

Beteja Frymërore: Fitorja e Krishtit mbi Botën, Mishin dhe Djallin



Beteja frymërore: Fitorja e Krishtit mbi botën, mishin dhe djallin

Që nga koha e krijimit të njeriut, Satani ka hyrë në një luftë të madhe dhe të vazhdueshme kundër Perëndisë dhe krijesës së Tij. Ai është përpjekur në çdo formë që të ndryshojë planin e përgjithshëm të Perëndisë për botën dhe për qenien njerëzore. Por premtimi dhe realizimi i shpëtimit të njeriut është kryer i plotë dhe i sigurt vetëm përmes sakrificës së Jezu Krishtit.

Satani vazhdon të luftojë e të trillojë, për të bërë që edhe ata që kanë marrë shpëtimin në Jezusin ta humbasin. Pra, na duhet ta kuptojmë se edhe ne, me të, po luftojmë në një betejë. Është një betejë të cilën Krishti e ka fituar, por që edhe neve na duhet që ta fitojmë duke qëndruar besnikë deri në fund me Të.

Zoti na vesh me armatimin e Tij për këtë betejë, që të mund të qëndrojmë kundër dredhive të djallit, duke na mësuar se beteja jonë nuk është kundër gjakut apo mishit, por kundër principatave dhe pushteteve të errësirës, kundër frymërave të këqija, kundër frymërave të liga.

Fitorja jonë arrihet ndërsa veshim gjithë këtë armatim dhe përmes lutjes, Perëndia lufton dhe siguron fitoren për ne. Jezusi, me vdekjen e Tij në Kryqin e Kalvarit, siguroi për ne fitoren mbi Satanin. Ai mori mbi vete të gjitha mëkatet tona, vuajtjet dhe vurratat tona dhe përmes ringjalljes së Tij, Ai na dha fitore edhe mbi vdekjen.

Në Krishtin, jemi të lirë nga mëkati; jemi të lirë nga veprat e mishit; jemi të lirë nga vdekja që nuk ka

më pushtet tek ne. Ai ka një plan të veçantë për ne, bijtë e Tij dhe ky plan është i koordinuar mirë, në harmoni me planin e Tij më të lartë.

Le t'i kërkojmë Atij, që të ndjejmë të njëjtën dashuri si Ai për mëkatarin dhe të njëjtën urrejtje si Ai për mëkatin. Le t'i kërkojmë Atij që të na japë gëzim dhe shpresë në lutje dhe përmes Frymës së Shenjtë të shohim e të festojmë fitoren e Krishtit dhe dështimin e Satanit. Duke këmbëngulur me një vendosmëri besimi, le ta shikojmë premtimin e Perëndisë të përmbushur dhe Satanin të turpëruar. Le t'i kërkojmë Atij që të ndezë në shpirtin tonë zjarrin e Frymës së Shenjtë, që lutjet tona të bëhen me një fuqi këmbëngulëse të vazhdueshme dhe vullneti i Tij të bëhet në tokë, ashtu si në qiell. Le ta mbushim shpirtin tonë plot me Fjalën e Perëndisë.

Le t'i kërkojmë gjithashtu, që kur Zoti përmes Frymës së Shenjtë të na japë shenjen për një betejë të veçantë frymërore, fryma jonë të jetë plotësisht e ushqyer me Fjalën e Perëndisë. Nuk mund të jemi të fortë frymërisht nëse lëmë pas dore leximin e Biblës.



GËZIM SPAHIJA,

Drejtor Ekzekutiv, Këshilli i
Përgjithshëm i Asambleve të
Perëndisë të Shqipërisë.

THESARE

Numri 4
Pranverë 2015

Koordinatorë e projektit: Stephanie Plagenhoef
Përkthyes: Fabian Tozharaku
Lindita Sqapi
Redaktues: Skënder Hoxha
Grafika kompjuterike: Lindita Sqapi

Botuar nga:
Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë
të Shqipërisë

Në bashkëpunim me:
Life Publishers International

Adresa: K.P. 119 / Kutia 2 / Tirana, Albania
Tel: (+355) 48-302611
Email: KTU@icc-al.org



Artikujt e zgjedhur dhe grafika përshtatur nga revista Enrichment - ©Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë, ShBA. Përdorur me leje.

©Life Publishers International. Të gjitha të drejtat të rezervuara.



ARMATIMI *i* PERËNDISË

Një Meditim mbi
Efesianëve 6:10–20

Nga: GEORGE O. WOOD

N*e duhet ta ushtrojmë me shumë kujdes pushtetin në luftën frymërore, duke u siguruar që po e përdorim atë në mënyrën e duhur dhe kundër armikut të duhur. Ja se si.*

Unë jam rritur në Kinën Veriperëndimore,

afër kufirit me Tibetin, ku shërbenin dy prindërit e mi misionarë

dhe kam dëgjuar edhe unë mjaft histori mbi gjëra të pazakonta.

Një nga më të paharrueshmet prej këtyre kishte të bënte me nënën time,

Elizabeth Weidman Wood, motrën e saj, Ruth Weidman Plymire dhe për

një natë të frikshme që ato kishin kaluar në një han kinez.



Mamaja dhe teze Ruthi kishin shkuar në Kinë si misionare të pamartuara. Sapo mbërritën, ato u regjistruan në shkollën e mësimi të gjuhës dhe shkuan për të banuar në një han aty pranë. Dhoma e tyre kishte një idhull budist. Atë natë të parë aty, ato nuk po i zinte dot gjumi. Ndjenin një prezencë të keqe të pazakontë. Krevati i tyre filloi të ngrihet pezull. Prezenca e keqe ishte aq shtypëse sa mezi mundeshin të flisnin. Në fakt, gjithçka mundeshin të belbëzonin ishte emri i Jezusit, por aq mjaftoi. Prezenca e keqe u zhduk dhe Fryma e Shenjtë i ngushëlloi ato.

Siç thuhet në kohët e sotme, mamaja dhe teze Ruthi patën një *takim fuqish*. Me anë të besimit në Jezus Krishtin, ato përzunë një frymë shtypëse nga dhoma e tyre. Shërbesat e Jezusit (Marku 1:39), Dymbëdhjetë Apostujt (Marku 3:14,15; Veprat 5:15,16), dhe apostulli Pal (Veprat 16:16–18; 19:11,12) të gjitha këto përfshinin edhe ekzorcizmin. Dhe ekzorcizmi vazhdon të jetë pjesë e luftës frymërore sot.

Por, ndërkohë që lufta frymërore përfshin ndeshje fuqish, këto ndeshje nuk marrin formën e ekzorcizmit. Tek Efesianëve 6:10–20, apostulli Pal lidh bashkë fuqinë, luftën frymërore dhe zhvillimin e dispozitave dhe disiplinave.

SË FUNDI...

Efesianëve 6:10–20 fillon me shprehjen *së fundi*. Kjo frazë tregon që çfarë vjen më tej është kulmi i mësimi të deritanishëm të Palit, jo vetëm pika e fundit në letrën e tij. Për të kuptuar atë që ai thotë në lidhje me luftën frymërore, ne duhet të mbajmë parasysh atë që ai ka thënë në kapitujt e mëparshëm të letrës së tij.

Vite më parë, Watchman Nee vuri re që ne mund ta artikulojmë mesazhin e Efesianëve në tri fjalë kyçe: *ulu*, *ec* dhe *qëndro*.

Ulu përshkruan “pozicionin tonë në Krishtin”: “(Perëndia) na ringjalli bashkë me të, dhe na vuri të rrimë bashkë me të në vendet qiellore, në Krishtin Jezus” (2:6). Të qenit tonë të ulur me Krishtin në të djathtë të Perëndisë është vepër e Perëndisë, që rrjedh nga “dashuria”, “mëshira”, “hiri” dhe “mirësia” e Tij (2:4,5,7,8). Ashtu siç ndodh kur ulesh në një karrige, ti e vendos gjithë peshën tënde mbi të, kështu, kur Perëndia na ul bashkë me Krishtin, ti e vë të gjithë peshën e shpëtimit tënd në hirin e Perëndisë.

Ecja përshkruan “jetën tonë në botë”: “Unë, pra ... ju bëj thirrje që të ecni denjësisht ndaj thirrjes që u thirrët” (4:1). Të krishterët nuk janë patate froni. Hiri nuk çon në pasivitet; ai aftëson për bindje aktive ndaj urdhërit të Perëndisë: “ne jemi rezultat i mjeshtërisë së Perëndisë, të krijuar në Krishtin Jezus për vepra të mira të cilat Perëndia i bëri gati që më parë që ne të ecim në to” (2:10, ESV).

Së fundmi, *qëndro* përshkruan “qëndrimin tonë ndaj armikut”: “Vishni gjithë armatimin e Perëndisë që të mund të qëndroni kundër kurtheve të djallit” (6:11). Ecja e krishterë nuk është një shëtitje në park. Efesianëve 6:10–13 e bën të qartë që ecja e krishterë është beteja e gjatë dhe e vështirë kundër ligësisë. Dhe në një betejë, qëllimi është që të mbash territorin tënd: të biesh është dështim, kurse të qëndrosh do të thotë fitore.

Duke mbajtur në mendje këtë përvijim, ulu-ec-qëndro të Efesianëve, ne shohim që lufta frymërore, nuk është aspak një aktivitet i jashtëzakonshëm i një elite frymërore, por është jeta e përditshme e çdo të krishteri të cilin Perëndia e ka shpëtuar me anë të hirit, shenjtëruar në bindje, dhe dërguar për t’ia shpallur ungjillin në bote që është e humbur dhe duke vdekur. Atëherë, të jesh i krishterë, do të thotë që të jesh në luftë.

FORCA E PUSHTETIT TË TIJ

Sidoqoftë, ndeshja në këtë luftë — pale pastaj korra e fitores — është shumë përtej aftësive të qenieve njerëzore. Fitorja i përket një fuqie shumë më të madhe se sa ne. Kjo është arsyeja se pse Pali na nxit: “fuqizohuni në Zotin dhe në forcën e pushtetit të Tij” (6:10). Vetëm Perëndia mund ta fitojë këtë luftë. Fitorja i përket atij — dhe neve — por vetëm nëse jemi në Të.

Gjuha e fuqisë hyjnore e përshkon të gjithë Letrën Drejtuar Efesianëve. Pali lutet tek Efesianëve 1:19, 20, që besimtarët të mund të përjetojnë “madhëshininë e jashtëzakonshme të fuqisë së tij ndaj nesh që besojmë”. Ai thotë më tej që është e njëjta fuqi, “të cilën e vuri në veprim në Krishtin, duke e ringjallur prej së vdekurish dhe duke e vënë të ulëj në të djathtën e tij në vendet qiellore.” Kjo fuqi është e nënkuptuar tek 2:6, ku fjalët *ringjalli* dhe *uli* përshkruajnë shpëtimin tonë me anë të hirit. Tek 6:10, folja “fuqizohuni” dhe fraza “forca e pushtetit të tij” janë një jehonë e fjalëve të 1:19, 20. Gjithashtu, Pali lutet për besimtarët që Perëndia të mund t’i “forcojë me fuqi nëpërmjet Frymës së Tij në njeriun e brendshëm, që Krishti të banojë në zemrat e tyre me anë të besimit” (3:16,17); dhe që besimtarët të fuqizohen “për të kuptuar me të gjithë shenjtoret cila është gjerësia, gjatësia, thellësia dhe lartësia, dhe të njohin dashurinë e Krishtit që tejkalon çdo njohuri” (3:18,19).

Lord Acton është i famshëm për vëzhgimin e tij: “Pushteti korrupton, dhe pushteti absolut korrupton në mënyrë absolute.” Ky vëzhgim i tij nuk i përshtatet Perëndisë, sigurisht, që përmbledh në vetvete edhe pushtetin absolut, edhe mirësinë absolute. Por me të vërtetë i përshtatet qenieve njerëzore mëkatore, madje edhe të krishterëve. Si mëkatarë, ne kemi tendencën që ta keqpërdorim dhe të abuzojmë me pushtetin, edhe kur jemi duke e përdorur atë në emrin e Perëndisë dhe për qëllimet e Tij.

Kjo është arsyeja se pse, ashtu si Pali, ne duhet që vazhdimisht të lidhim ushtrimin e pushtetit hyjnor me personin dhe punën e Jezus Krishtit. Me anë të fuqisë së Tij, Perëndia miratoi jetën, mesazhin, dhe vdekjen shpaguese të Jezus Krishtit duke e ringjallur atë prej së vdekuri dhe duke e ulur në të djathtë të Tij në lavdi. Dhe me anë të fuqisë së Tij, Perëndia na shpëtoi me anë të hirit dhe na thirri për të jetuar një jetë të shenjtë që arrin “masën e moshës së plotësisë së Krishtit” (4:13). Prandaj, të angazhohesh në luftën frymërore do të thotë të mbushesh me fuqinë që ishte në veprim në shërbesën e Krishtit. Nëse ne nuk e kemi kuptuar dhe nuk e manifestojmë gjerësinë, gjatësinë dhe thellësinë dhe lartësinë e asaj dashurie, atëherë e kemi humbur atë betejë.

Si pasojë, ne duhet ta ushtrojmë fuqinë në luftën frymërore me kujdes të madh, duke u siguruar që jemi duke e ushtruar atë në mënyrën e duhur dhe kundër armikut të duhur.

PUSHTETET E BOTËS SË ERRËSIRËS

Efesianëve 6:12 identifikon armikun në luftën frymërore: “beteja jonë nuk është kundër gjakut dhe mishit, por kundër principatave, kundër pushteteve, kundër sunduesve të përbotshëm të errësirës së kësaj jete, kundër frymërave të liga në vendet qiellore.”

Ka dy elemente në këtë identifikim:

Së pari, armiqtë tanë nuk janë “prej mishi dhe gjaku.” Me fjalë të tjera, armiqtë tanë nuk janë njerëz. Ne nuk duhet t’i demonizojmë kurrë personat të cilët Krishti erdhi që t’i shpëtojë (1 Timoteut 1:15; 2:4). Nuk ka rëndësi se sa kundër Perëndisë është besimi i tyre, pavarësisht sa imorale mund të jetë sjellja e tyre, pavarësisht se sa thellësisht na përbuzin dhe me sa forcë na sulmojnë, ne *nuk* jemi duke luftuar kundër njerëzve. Ne jemi duke luftuar për njerëzit në mënyrë që ata të mund të “nxirren... nga pushteti i errësirës dhe të zhvendosen në mbretërinë e Birit të tij të dashur” (Kolozianëve 1:13), ashtu si edhe ne.

Së dyti, armiqtë tanë janë “sundues”, “principata”, “pushtete” dhe “frymëra të liga”. Pali gjithashtu flet për “kurthe të djallit” (6:11) dhe të “të ligut” (6:16). Ne jemi duke luftuar kundër qenieve demonike.

Demonët kanë personalitete të çrregulluara. Të krijuar për t’i shërbyer Perëndisë, në vend të kësaj, ata me vullnet të plotë e refuzojnë Atë. Duke refuzuar Atë që është Realiteti më i Lartë, ata e humbasin realitetin krejtësisht. Mendjet e tyre nuk janë të akorduara sipas vërtetësisë, dhe veprimet e tyre nuk janë të drejtuara nga perëndishmëria. Jezusi na mëson që djalli është një “gënjeshtar dhe ati i gënjeshtër” (Gjoni 8:44). Pjetri shkruan, “kundër-shtari juaj, djalli, sillet rreth e qark si një luan vrumbullues, duke kërkuar cilin mund të përpijë” (1 e Pjetrit 5:8). Kudo që demonët janë të pranishëm, mashtrimi, mosbindja dhe shkatërrimi bëjnë kerdinë.

Qeniet demonike e manifestojnë veten në një sërë mënyrash. Në nivel individual, kjo manifestohet si pushtim, ku demonët kontrollojnë personalitetin e një individi. Mendoni për të demonizuarin në krahinën e gadarenasve (Marku 5:1–10). Para ekzorcizmit të tij, ai ishte vetëm, lakuriq dhe fizikisht jashtë kontrollit. Emri i tij ishte emri i demonëve sundues: “Legjion.” Mbas ekzorcizmit të tij, fqinjët e panë atë “ulur, të veshur dhe me mendjen në rregull.” Një i krishterë i mbushur me Frymën nuk mund të jetë i pushtuar në këtë mënyrë.

Qeniet demoniake, megjithatë, mundet të manifestohen në jetët e besimtarëve dhe jobesimtarëve edhe në mënyra të tjera. Ashtu si Jezusi vetë, njerëzit mund të jenë “të tunduar nga i ligu” (Mateu 4:1; krah. 6:13; 1 Korintasve 7:5; 1 Thesalonikasve 3:5). Përmes sjelljeve të padrejta, veçanërisht zemërimit, ata mund t’i “japin vend djallit” në jetët e tyre (Efesianëve 4:27). Demonët mund të manifestohen, me fjalët e Palit, edhe si “një gjemb në mish, një engjell i Satanit, për të më torturuar” (2 Korintasve 12:7). Qëllimi këtu është që ta bëjë personin, në mënyrë të veçantë besimtarin, që të dyshojë në mjaftueshmërinë e hirit të Perëndisë për ta (12:9).

Në një nivel shoqërie, qeniet demoniake mund të manifestohen me anë të sistemeve institucionale të mashtrimit, mosbindjes, dhe shkatërrimit. Kapitujt 12 dhe 13 tek Zbulesa flasin për tri krijesa të llahtarshme: “një dragua i madh i kuq flakë” (12:3), “ngjitej nga deti një bishë” (13:1), dhe “një bishë tjetër, që ngjitej nga dheu” (13:11). Gjoni e identifikon dragoin si ai “gjarpri i lashtë, i quajtur djall, edhe satan, që mashtron gjithë botën” (12:9). Djalli i jep bishës së parë “fuqinë e vet, fronin e vet dhe autoritet të madh” (13:2). Bisha e dytë “bënte që dheu dhe banorët e tij të adhurojnë bishën e parë” (13:12). Shumë komentues i interpretojnë bishat përkatësisht si institucionet sociale të politikës dhe fesë. Perëndia i krijoj këto institucione që të nxisë lulëzimin e njerëzimit: “sepse (eprori) është shërbenjës i Perëndisë për të mirën tënde” (Romakëve 13:4). Por ashtu siç sjellin çrregullim në jetën e një individi, kështu qeniet demoniake sjellin çrregullim edhe në jetën e një shoqërie të tërë.


Njerëzit nuk janë armiku ynë — nuk janë as ateistët e as myslimanët, as mbështetësit e abortit dhe as homoseksualët. Mosbesimi dhe imoraliteti i tyre janë kundër Perëndisë, por Perëndia nuk është kurrë kundër njerëzve. Dhe as ne nuk duhet të jemi të tillë. Lufta frymërore është misioni që Perëndia na jep në këtë epokë, një mision për të shpëputur njerëzit nga mashtruesi dhe shkatërruesi i shpirtit të tyre. Ne e përdorim pushtetin e Perëndisë në favor të tyre. Ne duhet të luftojmë për ta.

ARMATURA E TË KRISHTERIT

Kur e kuptojmë natyrën e armikut tonë, ne shohim se pse Pali na nxit që “të fuqizohemi në Zotin dhe në forcën e pushtetit të tij” (6:10). Qeniet demoniake janë më të fortë se ne, por jo më të fuqishëm se sa Perëndia ynë. Prandaj, Pali na nxit të “veshim të gjithë armatimin e Perëndisë” (6:11,13). Vetëm në këtë mënyrë do të jemi në gjendje që të “qëndrojmë kundër dredhive të djallit” (6:11). Armatura e

Perëndisë përshkruan mënyrën sipas së cilës ne duhet të ndeshemi me armikun.

Studiuesit shpesh thonë se Pali e përshkruan armaturën e Perëndisë duke pasur parasysh armaturën e një ushtari romak. Ka të ngjarë që të jetë kështu, sepse Pali e shkroi Letrën Drejtuar Efesianëve nga burgu (6:20) dhe kur ishte i rrethuar nga ushtarë romakë. Përshkrimi që Pali i bën armaturës, sidoqoftë, është një aludim ndaj pasazhit të profetit Isaia që e përshkruan Perëndinë dhe Mesianin e tij të veshur në një armaturë të ngjashme. Për shembull, Isaia 11:5 thotë për Mesianin: “Drejtësia do të jetë brezi i ijëve të tij dhe besnikëria brezi i anëve të tij.” Isaia 52:7 flet për bukurinë e “këmbëve të lajmëtarit që sjell lajme të mira.” Dhe Isaia 59:17 e përshkruan Perëndinë duke thënë se është veshur “me drejtësinë si me një parzmore dhe vuri mbi krye përkrenaren e shpëtimit.” Me fjalë të tjera, armatura e



Shpallja e fitores së Krishtit për misionin e Tij kërkon një betejë frymërore kolektivisht kundër autoriteteve dhe fuqive të ligësisë.

Perëndisë është pikë së pari dhe më e rëndësishmja, armatura e Atij vetë. Kjo është mënyra se si ndeshet Ai në luftën frymërore.

Si rrjedhojë, ndërsa Perëndia na vesh me armaturën e Atij vetë, ne futemi në luftën frymërore në të njëjtën mënyrë siç ndeshet Ai. Pjesët e ndryshme të armaturës që radhit Pali, në mënyrë metaforike përshkruajnë virtytet morale dhe praktikën misionare. Kur lexojmë për “brezin e së vërtetës” (6:14), për shembull, ne duhet të fokusohemi tek e “vërteta,” jo tek “brezi,” i cili përbën vetëm një metaforë. Mënyra se si ne luftojmë kundër djallit — mënyra se si Perëndia lufton kundër djallit — është nëpërmjet virtyteve morale siç janë për shembull thënia e së vërtetës, drejtësia dhe besimi, si dhe me anë të praktikave misionare të tilla si gatishmëria e ungjillit, fokusi në shpëtimin dhe shpallja e fjalës së Perëndisë.

Me fjalë të tjera, mënyra si zhvillohet lufta frymërore ka të bëjë, sa me atë se *kush ne jemi* (virtytet morale), po aq edhe me *çfarë ne bëjmë* (praktika misionare). Lufta ndaj pushteteve demoniake nuk është thjesht një çështje e ekzorcizmit të tyre. Ekzorcizmi është maksimumi një përlëshje fillestare në këtë luftë. Për të shkëmbyer metaforat dhe

huazuar një imazh nga një prej shëmbëlltyrave të Jezusit (Luka 11:24–26), mund të themi se ekzorcizmi dëbon djallin nga shtëpia jonë, por, synimi nuk është vetëm që ajo shtëpi të jetë vetëm “e fshirë dhe e stolitur.” Përkundrazi, synimi është që ta kthejmë atë shtëpi në një vatër ku Jezusi jeton çdo ditë. Ngjashmëria me Krishtin është synimi i luftës frymërore, esenca e fitores, dhe kjo vjen vetëm përmes punës së përditshme të ungjillizimit dhe dishepullizimit.

Për mendimin tim, shumë pentekostalë dhe karizmatikë merren tepër me ekzorcizmin e forcave demonike, qoftë në “nivel bazë” të pushtimit të një personi ose në një “nivel strategjik” të pushtimit nga një “frymë territoriale.” Ata bëjnë gabimin e mëtejshëm të reduktimit të luftës frymërore në ekzorcizmin, “lidhjen,” dhe “qortimin” e forcave frymërore. Ekzorcizmi është patjetër një komponent i luftës frymërore, në qoftë se do kishim vetëm rastin që disa njerëz janë të pushtuar nga demonët. Por mbasi ata janë çliruar, atëherë çfarë ndodh? Atëherë është momenti kur fillon në të vërtetë lufta e gjatë dhe e vështirë frymërore.

Asnjë person nuk mund të rritet në ngjashmërinë me Krishtin pa pasur ungjillizim dhe dishepullizim. Kjo është e vërtetë jo vetëm në kuptimin pasiv që ne vetë duhet të jemi të ungjillizuar dhe dishepullizuar. Kjo është e vërtetë edhe në kuptimin aktiv: Ne kemi nevojë që të ungjillizojmë dhe dishepullizojmë të tjerët. Të jesh i veshur me armaturën e Perëndisë do të thotë t’i kesh këmbët të veshura me “gatishmërinë e ungjillit të pages” (6:15). Është që të marrësh edhe “shpatën e Frymës, që është Fjala e Perëndisë” (6:17). Ungjillizimi dhe dishepullizimi janë “tehet prerëse” të luftës frymërore.

Kush jemi dhe çfarë bëjmë — virtytet morale dhe praktikat misionare — janë të ndërvanura dhe përforcuese të njëra-tjetrës. Ne nuk mund ta ungjillizojmë dikë tjetër me Lajmin e Mirë, pa e përjetuar edhe ne vetë këtë Lajm. Ne nuk mund të shpallim çlirimin nga djalli të të tjerëve nëse ai akoma ka një vend në jetët tona për shkak të zemërimit të padrejtë. Në mënyrë të ngjashme, ne nuk mund të ecim në bindje ndaj urdhërimeve të Perëndisë nëse shpërfillim urdhërimin final të Krishtit ndaj ndjekësve të tij: “bëni dishepuj të gjithë kombet” (Mateu 28:19). Ndërsa rritemi në ngjashmëri me Krishtin, ne bëjmë atë që bëri Krishti. Dhe ndërsa bëjmë atë që bënte Krishti, ne bëhemi më të ngjashëm me Krishtin.

ME GUXIM

Pali e përfundon diskutimin e tij mbi luftën frymërore me një nxitje për lutje ndërmjetësuese: “duke u lutur në çdo kohë dhe me çdo lutje dhe përgjërëm në

Frymë” (6:18). Ai kërkon lutje për “të gjithë shenjtorët” (6:18) si edhe për “mua” (6:19). Në mënyrë specifike ai kërkon nga efesianët që të luten për veprimtarinë e tij ungjillizuese: “(Lutuni edhe për mua) që kur të hap gojën time, të më jepet të flas me guxim për ta bërë të njohur misterin e ungjillit” (6:19).

Kjo thirrje për lutje është një përfundim i përshtatshëm për çfarëdo diskutimi mbi luftën frymërore, për tri arsye.

Së pari, lutja e vë në lëvizje dhe e implementon luftën frymërore. Ne nuk mund të prodhojmë virtyte morale apo praktika misionare as brenda vetes sonë, as duke i nxjerrë ato nga vetja jonë. Ato janë puna e Perëndisë brenda nesh. Lutja hap zemrën tonë ndaj Perëndisë në mënyrë që ai edhe të na shenjtërojë për veten e Tij, edhe të na fuqizojë për misionin.

Së dyti, lutja është një thirrje për Perëndinë që të veprojë. Fuqia jonë në luftën frymërore është fuqi nga Perëndia. Kjo armaturë që ne kemi veshur është e Perëndisë. Të përpiqesh që të përballesh me forcat e ligësisë pa thirrur ndihmën hyjnore është një orvatje e marrë. “Beteja i takon Zotit” (1 Samuelit 17:47).

Por, së treti, beteja e tij është edhe jona. Për shkak se Ai na ka dhënë pushtet, për shkak se Ai na ka veshur me armatimin e Atij vetë, ne mund të luftojmë dhe ta bëjmë këtë pa frikë. Në himnin e tij inkurajues, “Një Kala e Fuqishme është Zoti Ynë”, Martin Luther mat forcat me djallin dhe shkruan:

“Princi i zyrtë i Errësirës,

Prej tij nuk kemi frikë;

Inatin e tij mund ta durojmë,

Sepse, ja, fundi i tij është i sigurt,

Një fjalë e vogël e hedh atë përtokë.”

Ashtu siç zbuluan edhe mamaja ime dhe teze Ruthi një natë jo shumë kohë më parë, ajo fjalë e vogël është Jezus. Le të shkojmë përpara pa frikë kundër pushteteve të ferrit dhe të ngadhënjëjmë në emrin e Tij (Romakëve 8:37).



GEORGE O. WOOD, D.TH.P.,
është drejtor ekzekutiv i
Këshillit të Përgjithshëm të
Asambleve të Perëndisë,
Springfield, Missouri

Kujdes nga Gjembat e Satanit

Shtatë Mënyra se si i
Dobëson Armiku Pastorët

Nga: **STEPHEN LIM**

Ja disa nga mënyrat për t'iu shmangur strategjive që përdor Satani për të shpërqendruar, ngacmuar, dobësuar dhe shkatërruar pastorët.

P*se disa nga anëtarët e kishës sime nuk janë dakord me pozicionin tim mbi këtë çështje? Fundja, unë jam frymërisht më i përparuar se ata, mendoja unë në vetëmbrojtje. Kjo çoi në një përplasje në kishë që na mori shumë energji. Tani që hedh shikimin pas, arrij të kuptoj se kisha lejuar gjembat e Satanit që të më shponin mua.*

Ashtu siç i kundërvihej punës së Jezusit në tokë, ai dhe “forcat frymërore të ligësisë” i kundërvihen përpjekjeve tona për Perëndinë (Efesianëve 6:12). Ai vë në shënjestër veçanërisht pastorët. Sepse nëse i dobëson ata, ai ka dobësuar edhe Kishën.





KUJDES NGA STRATEGJITË E ARMIKUT

Si luftëtarë frymërorë, Pali na nxit që të qëndrojmë “kundër kurtheve (apo strategjive) të djallit” (Efesianëve 6:11). Për ta bërë këtë, ne duhet që pikë së pari të bëhemi të vetëdijshëm për to (2 Korintasve 2:11). Nga Bibla, dallojmë katër strategji kryesore që armiku i përdor kundër popullit të Perëndisë: sulmi, influenza demonike, mashtrimi dhe gjembat (2 Korintasve 12:7). Me anë të këtyre strategjive, ai përpiket t’i shpërqendrojë, ngacmojë, dobësojë ose shkatërrojë besimtarët.

Ky artikull fokusohet në shtatë gjemba që Satani i përdor kundër pastorëve. Nënartikulli plotësues, “Të Tjera Strategji të Armikut Kundër Pastorëve”, përmbledh edhe tri strategji të tjera.

GJEMBAT SHPËRQENDROJNË DHE DOBËSOJNË

Studiuesit e Biblës ofrojnë një gamë të gjerë interpretimesh për kuptimin e “gjembit në mish” të Palit, “një engjell i Satanit, për të më rënë me grushta” (2 Korintasve 12:7). Këto përfshijnë: depresion, kundërshtarë fetarë, rreziqe gjatë shërbesës, ose ndonjë lëngatë fizike të tillë si ndonjë problem me një nga sytë apo epilepsi. Një studiues sugjeron që Bibla mund ta ketë lënë qëllimisht kuptimin të papërkufizuar, në mënyrë që të krishterët të mund ta zbatojnë konceptin në rrethanat e tyre në vend që thjesht ta kufizojnë atë në problemin e veçantë të Palit.

Dhjata e Vjetër duket se tregon që “gjembat në ije” shkaktuan “telashe” për Izraelin (Numrat 33:55) dhe i përshkruan gjembat si përçmues (Ezekieli 28:24). Nga përvoja jonë, kur një gjemb na futet në mish, ai e shpërqendron vëmendjen tonë larg asaj që jemi duke bërë. Ai shkakton dhimbje dhe mund ta pengojë funksionimin normal. Prandaj dhe ne kuptojmë se një gjemb në mish për një pastor është diçka që e bën Satani dhe që mund të shkaktojë një apo më shumë nga sa vijon: *shpërqendron* pastorin nga thirrja e Perëndisë, *shkakton dhimbje* në trupin e tij apo saj, ose e *dobëson* shërbesën e tij apo të saj.


Ja shtatë prej këtyre gjembave dhe si mund të shmangen ata.

SUPERIORITETI FRYMËROR

Tek 2 Korintasve 10–12, apostulli Pal flet për rrezikun e krenarisë frymërore që mund të rritet nga kredencialet frymërore, masa e vuajtjeve për Krishtin dhe nga zbuluesat që ne marrim nga Perëndia. Burime të tjera për krenarinë mund të jenë: dhuntitë tona frymërore, statusi ynë në shërbesë, suksesi që Zoti jep dhe madje nga karakteri ynë. Pastori i Asambleve të Perëndisë Richard Dortch ka bërë një rrëfim në lidhje me krenarinë e tij për shkak të integritetit të lartë frymëror që ai kishte.¹

Symptomat e mëposhtme na paralajmërojnë edhe ne për këtë gjemb të superioritetit frymëror:

- Të parit si më inferiorë ndaj nesh të atyre që ne i perceptojmë si më pak frymërorë, më pak të suksesshëm apo të aftë.
- Të kaluarit pak kohë me “njerëzit e vegjël”, duke preferuar shoqërimin me “njerëz të rëndësishëm”. Fundja, ne jemi një prej tyre. Përkundrazi, Jezusi kishte kohë për fëmijët, për askushët e shoqërisë së shekullit të parë.
- Shfrytëzimi i pozitës sonë për t’i përdorur njerëzit që të kënaqim ambiciet tona — të shenjtëruara sigurisht, duke i quajtur madje vullneti i Perëndisë.
- Refuzimi për të toleruar mospajtime të shëndetshme apo për të kërkuar në mënyrë bashkëpunuese vullnetin e Perëndisë. “Meqenëse unë jam dhe frymërisht më superior, vizioni im është ai i duhuri. Dhe pikë. Përveç kësaj, kush janë ata që të kundërshtojnë të vajosurin e Zotit?”



Krenaria frymërore rezulton në përçarje dhe grindje kur të tjerët i rezistojnë opinionit tonë të mençur që supozohet se është superior. Gjithashtu ndodh edhe humbja e kurajës dhe e përkushtimit, kur të tjerët ndjejnë se drejtuesit nuk duan t’ia dinë më për ta. As nuk e ndiejnë më të tyrin vizionin që është bërë “synimi i pastorit” në vend që të jetë “ëndrra jonë e dhënë nga Perëndia”. Një ndjesi superioriteti, gjithashtu na verbon ndaj dobësive tona. Ne të gjithë njohim pastorë që janë rrëzuar si pasojë e kësaj.

Shmangia e gjembit të superioritetit frymëror kërkon *përlulësi frymërore*. Së pari, ne nuk kemi asgjë përveç asaj që kemi marrë nga Perëndia — qoftë aftësi, dhunti frymërore, mundësi shërbese apo të korra (1 Korintasve 4:7). Së dyti, ne duhet të pranojmë se nuk mundemi të funksionojmë pa të tjerët (1 Korintasve 12). Së treti, Pali udhëzon: “Me përlulësi, secili ta çmojë tjetrin më shumë se vetveten” (Filipianëve 2:3). Së fundmi, Biri i Perëndisë e modeloi për ne përlulësinë në mishërimin, vuajtjen dhe vdekjen e Tij (vargjet 6–11).

Pak mbasi u bëra dekan akademik në Seminarin Teologjik të Asambleve të Perëndisë, unë udhëhoqa konferencën vjetore të fakultetit që i paraprinte fillimit të vitit shkollor. Atje, në fjalinë e parë drejtuar profesorëve, unë thashë: “Unë kam qenë dekan prej 6 ditësh tashmë. Në këtë kohë, a jam bërë papritur më i zgjuar sesa ju?” Unë doja që ata ta dinin se nuk kisha ndërmend që të veproja nga një pozitë superioriteti, por si një udhëheqës shërbëtor.

VETË-MJAFTUESHMËRIA

Në kulturën tonë, pastorët mund të kenë në dispozicion burime me bollëk. Në vend që të mbështeten tek Perëndia që ua siguron ato, ne mundemi që fare lehtë, të mbështetemi në burimet tona vetjake. Ne mund të varemë në asetet personale: arsimimin, personalitetin, përvojën, inteligjencën, komunikimin, aftësitë sociale, si edhe tek udhëheqësia. Për më tepër, ne mund të kemi në dispozicion anëtarë të përkushtuar, staf të aftë, një organizim të fortë, financa, dhe ndërtesa të bukura dhe burime të tjera mbi të cilat të mbështetemi. Këto na japin pamjen e jashtme të suksesit, por ato prodhojnë pak vlera të përrjetshme frymërore. Vetëm ndërkohë që qëndrojmë me të vërtetë të lidhur me Jezusin, duke u varur plotësisht prej tij, mundemi që të “japim shumë fryt” (Gjoni 15:4,5).

Me pak burime, megjithatë, ne na duhet të varemë nga Perëndia. Ne shohim rritje eksplozive të kishës në shumë vende të pjesës më të madhe të botës. Atje, kishat shpeshherë kanë pasuri minimale, por besim të madh dhe varësi të plotë nga Perëndia. Ato na tregojnë se pse ne duhet ta shmangim gjembin e vetë-mjaftueshmërisë.

Pali u lut tri herë që Perëndia ta largonte atë gjemb prej tij. Megjithatë Perëndia e lejoi shërbëtorin e Tij që të vazhdonte të vuante nga një gjemb i Satanit. Pse? Në mënyrë që Pali të vazhdonte të varej nga Perëndia. Ai i tha Palit: “Hiri im të mjafton, sepse fuqia ime përsoset në dobësi” (2 Korintasve 12:8,9). Vetë-mjaftueshmëria e kufizon aq shumë punën e Perëndisë në jetët tona sa Krishti mund të lejojë që të përjetojmë një gjemb në mënyrë që të shmangë diçka tjetër akoma më të dëmshme.

Le t'u hedhim një sy edhe gjembave të tjerë.

SINDROMA E SUPERMENIT ²

“Si pastor, plotësimi i të gjitha nevojave të kishës sime varet nga unë. Për më tepër, unë duhet të bëj çdo gjë që të mundem për të arritur sa më shumë njerëz të humbur që të jetë e mundur. Kështu që unë duhet të vazhdoj ta shtyj veten akoma më tej.” Me qëndrime të tilla, për më shumë se një dhjetëvjeçar, unë ngrihesha çdo ditë në 4:50 të mëngjesit pa sasinë e nevojshme të gjumit, në mënyrë që të kisha kohën me Zotin në orën 5:00 dhe të bëja ca orë punë para se të hahej mëngjesi. Megjithatë, shpeshherë unë kaloja ditë joproduktive si pasojë e pagjumësisë.

Ndërkohë që për ndonjë ngjarje të papritur mund të na duhet të kalojmë orë të mundimshme, ne funksionojmë më efektivisht dhe jemi më krijues nëse pushojmë sa duhet. Problemi im? Për arsye të pashëndetshme frymërore, unë kisha marrë përsipër

përgjegjësinë e shërbesës së Perëndisë. Ai na thërret që të bashkëpunojmë me Të në mision, dhe jo të marrim mbi vete pronësinë dhe barrën e saj. Më në fund e dëgjova Perëndinë të më thotë: “Lehtësohu ca. Nuk ka nevojë që ta shpëtosh ti botën. Vetëm Biri im mund ta bëjë këtë. Ti nuk je Shpëtimtari; e as Supermeni. Kështu që hiqe atë kapele.”

Unë vuaja nga gjembi që tani e quaj Sindroma e Supermenit. Simptomat përfshijnë mbilodhje dhe irritim, të cilat rriten e kthehen në mllëf — dhe më në fund në rraskapitje totale. Kjo rezultoi në atë që ne pastaj ose i bëjmë shërbesat si robotë ose edhe i braktisim fare. Ndërkohë edhe familjet tona lihen mbas dore duke u anashkaluar nevojat e tyre dhe tonat.

Gjatë shërbesës së Tij, Jezusi kurrë nuk dukej i stresuar apo në ankth. Ai i pranonte kufizimet e pjesës njerëzore të natyrës së Tij dhe e vlerësonte nevojën për pushim dhe përtëritje. Ai fjeti në një



Të Tjera Strategji të Armikut Kundër Pastorëve

Përveç “gjembave” frymërore, që Satani mund t'i përdorë kundër pastorëve, ai përdor edhe tri strategji të tjera kundër besimtarëve.

Sulm dhe Shkatërrim

Së pari, armiku kërkon që të sulmojë dhe të shkatërrojë. Pjetri na paralajmëron që ai “sillet rreth e qark si një luan vrumbullues, duke kërkuar cilin mund të përpijë” (1 Pjetrit 5:8). Jezusi thotë se Ai vjen “vetëm për të vjedhur, vrarë dhe shkatërruar” (Gjoni 10:10). Pali i përshkruan këto sulme si “shigjeta të zjarrta” (Efesianëve 6:16). Si një shërbyes i ungjillit, Pali duroi burgosje të shumta, rrahje dhe kamxhikë dhe madje i mbijetoi

një tentative vrasjeje me gurë. Sulmet mund të përfshijnë edhe diskriminime, ngacmime, uzurpim prone dhe vdekje. Të gjithë apostujt përveç Gjonit, vdiqën për besimin e tyre. Pastorët dhe besimtarët në shumë vende sot vuajnë rregullisht nga përndjekje dhe sulme. Vetëm me fuqizimin e Perëndisë me anë të lutjeve ata janë në gjendje që të durojnë.

Influenca Demonike

Së dyti, armiku i ndikon të krishterët deri në atë masë që ata e lejojnë me anë të mosbindjes apo shkujdesjes frymërore. Si qenie frymërore, ose Fryma e Perëndisë ose frymëra të huaja ndikojnë mbi ne. Kur ne e kufizojmë udhëheqjen e Frymës në jetët tona, frymëra të liga do të marrin më shumë terren për të influencuar. Ne shohim dy raste të spikatura të udhëheqësve që u rrëzuan: Mbretin Saul (1 Samuelit 16:14; 18:10; 19:9) dhe Judën, të cilin djalli “e shtyu ... që ta tradhtojë Jezusin” (Gjoni 13:2). Le të qëndrojmë përplot me Frymën e Perëndisë (Efesianëve 5:18) dhe të minimizojmë influencën e frymërave të tjera.

Mashtrimi

Së treti, Pali paralajmëron që

Satani “shndërrohet në një engjell drite” (2 Korintasve 11:14). Ata që ai nuk mund t'i sulmojë ose t'i nxisë për të mëkatuar, ai i tundon që të ndërmarrin veprime që duken si të padëmshme, të mira dhe madje fisnike, por që janë larg nga vullneti dhe qëllimet e Perëndisë. Për shembull, dy tundimet e para të Jezusit në shkretëtirë duken të arsyeshme dhe madje biblike, por ishin kundër vullnetit të Perëndisë për Të (Mateu 4:1–7).

Për të shmangur mashtrimet të tilla, ne kemi nevojë që të: zhytemi në Fjalën e Perëndisë, të ecim sa më afër Tij, të kërkojmë dhuntinë e dallimit dhe ta vendosim veten në pozita llogaridhënëse ndaj një grupi të vogël besimtarësh të cilët na njohin mirë.

Fito

Të vetëdijshëm ndaj strategjive të armikut, pastorët mund të fitojnë duke veshur “të gjithë armatimin e Perëndisë”, duke marrë “shpatën e Frymës, që është fjala e Perëndisë”, dhe duke u lutur “në Frymë në çdo kohë dhe me çdo lloj lutjeje” (Efesianëve 6:11,17,18).

STEPHEN LIM, D.Min.
Springfield, Missouri

barkë gjatë një stuhie të ashpër. Shpeshherë ai largohej e qëndronte veçmas për periudha të gjata kohe për t'u lutur. Ai gjithashtu kalonte kohë me miqtë e Tij: Llazarin, Martën dhe Marinë.

Në rast se Jezusi i kuptonte kufizimet e Tij njerëzore, sa më tepër duhet që edhe ne t'i kuptojmë kufizimet tona? Për ta shmangur Sindromën e Supermenit, ne duhet t'ia kujtojmë vetes se jemi njerëz. Gjithashtu, duhet të kujtojmë që Perëndia na ka thirrur që të bashkëpunojmë me Të në misionin e Tij, jo ta marrim atë vetë përsipër.

JOSHJA SHOQËRORE

Në përpjekjen e tij të tretë për ta tunduar Jezusin, Satani i ofroi Atij të gjithë pushtetin, pasuritë dhe lavdinë e botës. Gjithçka që Jezusi duhej të bënte

shkretëtire në drejtim të Gazas. Po ta vëmë veten në vend të tij, imagjinoni se çfarë mund të mendonim sapo të mbërrinin: *"Hmm, nuk po shoh ndonjë stadium ku të bëj fushatën time të ungjillizimit. Ku janë turmat këtu? Nuk ka asgjë këtu veç shkreti. Unë lashë mbrapa një të korrë të bollshme frymërore në Samari për të ardhur këtu? Çfarë humbje e kotë e kohës sime!"*

Së fundi, Filipi takoi një etiopas në rrugë dhe e udhëhoqi tek Krishti. Ai mund të ketë pyetur veten se pse iu desh të shkëmbente qindra konvertime për një person të vetëm.

Etiopasi u kthye në vendin e tij. Ai e ndau ungjillin me familjen e tij dhe miqtë. Gradualisht edhe ata erdhën në besim. Nga ana e tyre, edhe ata e ndanë ungjillin me të tjerë. Kjo ndodhi me kalimin e muajve dhe



ishte që të përulej e ta adhuronte atë. (Mateu 4:8–10). Bota gjithashtu kërkon që të na joshë me vlerat dhe pasuritë e saj. Armiku na tundon që të bëjmë kompromise. Ndonjëherë kemi dhe motive të mira. Fundja, arsyetojmë, do të jetë ndihmë për punën e Zotit nëse do të kishim një pozitë më të lartë apo reputacion më të gjerë ose ndërtesë më të madhe. Në disa raste ky mund të jetë vullneti i Zotit. Megjithatë, a jemi duke lejuar vlerat e botës për gjëra më të larta, më të mëdha, më të shumta, që të na joshin jashtë vullnetit të Perëndisë për shërbesat tona?

MALLKIMI I KRAHASIMIT

Gjembi i krahasimit është e kundërta e superioritetit frymëror dhe është akoma më i përhapur mes pastorëve. Shumë shpesh ai çon në dekurajim dhe humbje të entuziazmit dhe të energjisë për të shërbyer. Ne i derdhim zemrat në misionin për të cilin na ka thirrur Perëndia. Në mënyrë të pashmangshme, ne i shohim të tjerët që kanë arritur edhe më shumë. "Ai ka një bashkësi me mijëra anëtarë. Kisha ime ka vetëm 200 anëtarë. Ndërtesa e saj ka 2,800 metra katrorë hapësirë, 10 herë më shumë se sa kisha ime." Krahasimi ngjiz ose acaroon një lloj ndjesie inferioriteti që çon në dekurajim.

Perëndia i tha Filip ungjilltarit që të udhëtonte për disa ditë me radhë në një rrugë përmes një

viteve, pastaj brezave dhe shekujve. Si rezultat, me miliona etiopas janë tani ndjekës të Krishtit. Filipi nuk kishte akses në internet, as në televizion, e as në gazetatat e përditshme. Ka shumë të ngjarë që ai as nuk i ka marrë vesh kurrë rezultatet e bindjes së tij.

Historia e Filipit na tregon që Perëndia na thërret që të jemi besnikë, e jo për ta krahasuar veten me të tjerët. Disa Ai i thërret në vende që i rezistojnë ungjillit për vite me radhë; me një plugim të vështirë dhe fryte të pakta. Të tjerë Ai i thërret në fusha me të korra të pjekura gati për t'u mbledhur me fare pak mundim nga ana e tyre. Në ditën e gjykimit kush do të marrë lëvdatat më të mëdha?

Në Shëmbëlltyrën e Jezusit për Talentat (Mateu 25:14–30), shërbëtori që investoi dy talentat që iu besuan atij nga pronari dhe fitoi edhe dy të tjera mori lavdërimin: "Të lumtë, shërbëtor i mirë dhe besnik" (vargu 23). Vini re që shërbëtori që mori pesë dhe fitoi pesë të tjera mori të njëjtën lëvdatë (vargu 21). Nuk ka dyshim, nëse ai që mori një talent do ta kishte investuar atë për të fituar një talent tjetër, ai do të kishte marrë të njëjtin miratim dhe shpërblim si edhe të tjerët.

Ne duhet ta refuzojmë mallkimin e krahasimit. Ky gjemb na demoralizon dhe na dobëson. Le të bindemi me besnikëri ndaj thirrjes së Perëndisë dhe t'ia lemë Atij rezultatet.

FRYT I RREMË

Një shportë me fryte plastike dekoron tryezën time në kuzhinë. Ato duken si të vërteta, por, ju lutem mos provoni t'i kafshoni. Pastorët shpesh bien në kompromis për të pranuar atë që duket si fryt i vërtetë frymëror, por që në fakt nuk është. Kisha në Sardë kishte "namin se ishte e gjallë," por ishte shpirtërisht e vdekur (Zbulesa 3:1). Konvertime të qëndrueshme dhe besimtarë që rriten si dishepuj të pjekur janë fryti i rëndësishëm i shërbesës (Mateu 28:19). Duke mos arritur këtë, drejtuesit shpesh i zëvendësojnë me synime të lehta të shtimit të pjesëmarrjes, programe, ndërtesa dhe rritje të dhënies. Këto na japin një reputacion frytshmie, por ato mund të mos prodhojnë frytin e përfundimtar që dëshiron Perëndia.

Pastor Walt Kallestad e udhëhoqi kishën e tij me mbi 12,000 pjesëmarrës në takimet e fundjavave. Në fund, ai pohoi se ata kishin arritur sukses në "garën për kuotën e tregut," por kishin dështuar në misionin e tyre sepse "nuk ishin duke prodhuar dishepuj të fuqizuar."³ Ai vendosi që ta ndryshonte fokusin e Tij drejt thirrjes së misionit të Perëndisë.

Kënaqja me frytet e rreme na e rrit reputacionin, por na lë duarbosh në ditën e gjykimit. Për ta shmangur këtë gjemb, ne duhet të fokusohemi në përmbushjen e Porosisë së Madhe dhe Urdhërimit të Madh.

PËRJASHTIMI EKZEKUTIV

Nëse pastorët nuk janë të kujdesshëm, sa më i madh të jetë sukcesi që ata gëzojnë — sa më e madhe bashkësia e tyre dhe sa më zhurmëmadhe duartrokja — aq më shumë fillojnë që të mendojnë se ata janë një përjashtim nga rregulli. Mbreti David kreu tradhti bashkëshortore me Bathshebën dhe pastaj e mbuloi atë duke urdhëruar vrasjen e burrit të saj. Tre nga nëntë presidentët e fundit amerikanë kanë pasur dështime serioze morale. Kohë pas kohe media bën publike dështime morale të një tjetër pastori të shquar. Secili prej këtyre individëve i ka dhënë vetes një përjashtim nga norma e ligjit të Perëndisë.

Për ta shmangur gjembin e përjashtimit ekzekutiv, pastorët duhet së pari ta përkushtojnë veten për të nderuar ligjin e Perëndisë dhe për të pasur një sjellje me integritet në çdo fushë të jetës së tyre. Ata do të kenë nevojën e njerëzve të tjerë të besuar për të zbuluar tundimet ndaj të cilave ata janë më të prekshëm. Gjithashtu, ata kanë nevojë që të hapin jetët e tyre ndaj këtyre individëve e të jenë llogaridhënës para tyre.

KUJDES NGA GJEMBAT E SATANIT

Gjembat që përmenda më lart nuk i përfshijnë të gjitha mundësitë e as nuk i shterojnë ato. Përkundrazi, unë kam shtjelluar disa nga gjembat më të zakonshëm të cilët mund t'i shpërqendrojnë pastorët nga thirrja e Perëndisë dhe mund t'i dëmtojnë shërbesat e tyre. Unë e pohoj se kam lejuar secilin prej tyre që ta dobësojë shërbesën time pastorale. Jam mirënjohës që Fryma e Perëndisë më ka rritur përgjatë viteve dhe unë kam mësuar që të kem kujdes nga gjembat e Satanit. Me aftësimin nga ana e Perëndisë, ne mund t'i rezistojmë çdo gjembi të armikut.



STEPHEN LIM, D.Min., është dekan akademik dhe profesor i udhëheqësisë dhe i shërbesës, në Seminarin Teologjik të Asambleve të Perëndisë, Springfield, Missouri.

Shënime

1. Richard Dortch, *Integrity: How I Lost It, and My Journey Back [Integriteti: Si e Humba Unë Atë, dhe Udhëtimi im i Kthimit]* (Green Forest, Arkansas: New Leaf Press, 1992), 312.
2. Përshtatur nga Stephen Lim, "Overcoming the Superman Syndrome," [Mposhtja e Sindromës së Supermenit] *Revista 'Ministry International Journal' për Pastorët*, Maj 2002.
3. Walter Kallestad, "Redefining Success," [Ripërkufizimi i Sukcesit] *Fuller Theology, News, & Notes*, Vjeshtë 2006, 6. Publikuar në origjinal në revistën *Leadership Journal*.

© 2011 Paul F. Gray




"Duhet t'ia rrëfejmë fajet njëri-tjetrit...! Unë kam fajin se jam treguar tepër i mirë. Tani e ke radhën ti."



Beteja e Ideve, Koncepteve, *dhe* Mendimeve

Nga: PAUL ALEXANDER

Ndonjëherë ndihemi sikur
kërcënohemi nga një re e zezë në
horizont, që duket se do të
zbrazë një stuhi mbi ne e cila do
t'i përmbysë bindjet tona të forta
dhe do e kanosë besimin tonë.



Lufta frymërore
shpeshherë
zhvillohet në sferën
e ideve, koncepteve
dhe mendimeve.
Kështu që, si duhet
të përballen në
siguri pastorët dhe
të krishterët në
përgjithësi me këtë
betejë? Më poshtë
janë tri mënyra
përmes të cilave
mund të përfshihemi
në këto shprehje të
luftës frymërore.

Shekulli i ri ka sjellë shumë ndryshime.

Për drejtuesit e krishterë ndryshimet më domethënëse nuk janë teknologjitë e reja apo stilet e adhurimit, por janë zhvendosjet e mendësive të njerëzve. Parimet morale universale nuk ekzistojnë më, dhe strukturat shoqërore të cilat na kanë shërbyer për shekuj me radhë po shkatërrohen. Ndonjëherë mund të ndihemi sikur ekziston një rend dite progresiv i cili nuk është edhe aq miqësor ndaj jetës dhe besimit të krishterë.

Këto ndryshime përfaqësojnë një lloj të ri lufte frymërore: një betejë idesh, konceptesh dhe mendimesh. Nuk ekziston një armik i dukshëm për t'u dëbuar, nuk ka ndonjë demon që nxjerr sqfur nga goja për t'u përzënë dhe as ndonjë manifestim i frymërave të liga për t'u rrëzuar. Këto ide, koncepte dhe mendime kanë zaptuar sistemin tonë arsimor dhe nxisin shkencat shoqërore. Disa e quajnë këtë *humanizëm laik*, por ai është diçka më e ndërlikuar se kaq. Është një botëkuptim post-kolonizator, post-superfuqish dhe post-modern i shtyrë nga media popullore. Është diçka që e imponon vetveten në të gjitha aspektet e jetëve tona – tek kishat tona, grupet e të rinjve dhe shkollat tona.

Shprehjet e reja të pluralizmit ofrojnë prova të kësaj beteje frymërore. Nuk është e pazakontë që shumë prej atyre që vijnë në kishat tona të kenë botëkuptime fetare hibride. Për ta, paradoksi i përqaimit të një natyre frymërore të krishterë dhe njëkohësisht i një moraliteti laik nuk duket se përbën një sfidë. Auditorët e shkollave, media dhe diskutimet e kafeneve – në vend të adhurimit, predikimit dhe mësimi të Biblës – janë ato që falsifikojnë gjithmonë e më në rritje pikëpamjet rreth martesës, seksualitetit, ngarkesave të borxhit, besnikërisë, ose mënyrës se si duhet menaxhuar mjedisi. Rrjedhimisht, nga kjo krijohet një mish-mash idesh dhe vlerash të cilat shpesh rezultojnë në kokëçarje për njerëzit e mirë që ndërkohë mundohen të kuptojnë jetët e tyre.

Shërbesa pastorale është në vijën e frontit të kësaj beteje. Jetesa jofunksionale është diçka epidemike. Trysnia shoqërore dhe rregullimi me ligj gjithmonë e më tepër në rritje nga autoritetet ligjvënëse e bëjnë të vështirë që të përballemi haptazi me çështje, siç na sugjeron edhe teologjia jonë që duhet të bëjmë. Kjo lloj trysnie na detyron të ecim me kujdes ndërsa merremi me problemet e shumta me të cilat përballen njerëzit, që të mos krijojmë mundësira për ndonjë formë kontestimi kundër nesh. Ka pasur pastorë që i kanë hedhur në gjyq kishat sepse i kanë shkarkuar ata për arsye moraliteti. Ata janë rrekur të argumentojnë në gjyq se ajo që dikush bën në jetën e tij ose të saj private nuk ka asnjë lidhje me punësimin. Nuk është çudi që ndonjëherë ne ndihemi sikur kërcënohemi nga një re e zezë në horizont e cila duket se do të zbrazë një stuhi mbi ne që do t'i përmbysë bindjet tona të forta dhe do e kanosë besimin tonë.

Kjo është një betejë e lashtë. Pavarësisht se shprehjet e kësaj lufte kanë ndryshuar, forca parësore që qëndron pas tyre është ligësia. Apostulli Pal flet për një filozofi të cekët dhe mashtruese e cila i mban njerëzit robër (Kolosianëve 2:8). Ai na kujton se beteja jonë është kundër argumenteve dhe kundër çdo pretendimi që ngrihet kundër njohurisë së

Perëndisë (2 Korintasve 10:5). Në shumicën e rasteve, njerëzit e citojnë këtë varg në lidhje me luftën frymërore.

Sipas mendimit tim, ndonjëherë mund të gjendemi përpara rrezikut të keqpërdorimit të Dhjatës së Re për të mbrojtur veten nga një pikëpamje e caktuar, edhe e teologjisë, edhe e praktikës së luftës frymërore. Po shpjegojmë më mirë.

Pjesa kryesore e argumentit të Palit tek 2 Korintasve 10:3-6 është çështja e besnikërisë në kishën e Korintit. Disa "super dishepuj" po përhapnin ide alternative dhe perspektiva kontradiktore teologjike (2 Korintasve 11:5). Këto shpeshherë pasoheshin nga sulme personale kundër Palit, apostullit që e themeloi atë kishë. Si rrjedhojë, kisha humbi një masë besimi tek Pali dhe e hapi veten ndaj një morie konceptesh dhe idesh të cilat po krijojnë pasiguri frymërore dhe luftë të brendshme. Këshilla e Palit ishte që të kapej çdo mendim dhe të bëhej i bindur ndaj Jezus Krishtit. Ai gjithashtu e bëri të qartë që korintasit duhet t'i rrëzonin bastionet me anë të fuqisë së Perëndisë. Edhe pse nuk mund ta përjashtojmë kurrë aktivitetin e forcave djallëzore, një parashtrim i këtij pasazhi në kontekst do ta përforconte pozicionin se lufta frymërore shpesh ndodh në sferën e ideve, mendimeve dhe koncepteve.



Më lejoni të sugjeroj disa nga arenat në të cilat po ndodh kjo betejë rreth e rrotull nesh:

ARENA KULTURORE

Kultura është e ndërlikuar dhe e vështirë për t'u përkufizuar. Ajo ka nënkategori të shumfishta, por gjithsesi është e mundur të identifikohen struktura gjithëpërfshirëse të cilat përcaktojnë mënyrën si funksionon një shoqëri. Shuma e plotë e gjuhës, vlerave, normave dhe sjelljeve kontribuon në përkufizimin e një kulture. Në mënyrë dërrmuese, forcat e globalizimit ndërtojnë kulturën e shekullit të 21-të. Ndërkohë që bota filloi të rindërtohej pas shkatërrimit të Luftës së Dytë Botërore, kombet dhe popujt e kolonizuar – të cilët ishin shfuqizuar nga aspiratat shfrytëzuese të kombeve perëndimore – filluan të kërkojnë të drejtat e tyre për të qenë të lirë e të pavarur. Përleshja për toka dhe kombe kishte mbaruar dhe tani rendi i ditës vihej në lëvizje nga të drejtat e njeriut, të drejtat civile dhe nga pasioni për përmbushjen e potencialit të dikujt. Vazhdimësia e praktikave raciale në shumë pjesë të botës, efektet shkatërrimtare të luftërave rajonale siç ishte lufta e

Vietnamit, si dhe zhvillimi me ritme të shpejta i teknologjisë e cila na lejon të dërgojmë brenda disa sekondave imazhe grafike në të gjithë botën, i modeloi këto forca të ndërlikuara. Kush mund ta harrojë imazhin e vajzës së vogël vietnameze që vraponte e zhveshur nga sulmi me napalm apo brutalitetin e egër policor kundër banorëve të pafajshëm të qytezës Sharpvill në Afrikën e Jugut? Deri në fund të viteve 1960 dhe në fillim të viteve 1970, këto forca u shfaqën si sulme koherente kundër gjendjes ekzistuese. Lëvizja e të drejtave civile pati një sukses domethënës; lëvizja pro-zgjedhjes (kundër abortit) fitoi në sallat e gjyqeve dhe e ndryshoi shoqërinë në nivel global.

Në këtë botë rrënjësisht të ndryshme u lind brezi i quajtur “i mijëvjeçarëve”. Si pasojë, ata janë rritur me një mendësi e cila i refuzon historitë e mëdha. Për ta, ata të cilët kanë të gjitha përgjigjet duken si luftënxitës të shekullit të 20-të. Ata kanë një teori interpretimi të përbërë nga dyshimi dhe, njësoj si

vetëm paraprak për marrëdhëniet seksuale. Barrat e borxhit të cilat i sakatosnin vendimet e njerëzve për vite me radhë ishin plotësisht të pranueshme; dhe, nëse nuk arrinin të paguanin në kohë, nuk ishte faji i tyre. Të gjithë fajin e kishte qeveria ose bankat e mëdha. Sipas mentalitetit të tyre, marrëdhëniet midis të njëjtës gjini nuk përbënin ndonjë problem. Në mënyrë paradoksale, po këta studentë të rinj (të një kolegji biblik) kishin një përkushtim të madh ndaj mjedisit dhe ofendoheshin nëse normat e riciklimit nuk po rriteshin. Lajmi i mirë është se jo të gjithë studentët kanë pasur këtë botëkuptim. Përmes angazhimit në këtë betejë frymërore në klasat e shkollave, në kisha dhe në udhëtime misionare, shumica e studentëve u diplomuan me një pasion për Krishtin dhe me një dashuri për Fjalën e Tij.

Thelbi është se nuk duhet të jemi injorantë ndaj mjedisit aktual kulturor dhe ndaj nivelit të luftës frymërore që ajo krijon. Duhet ta përballojmë këtë betejë me besim dhe siguri. Sugjerimet në fund të



Trysnia shoqërore dhe rregullimi me ligj gjithmonë e në rritje nga autoritetet ligjvënëse, e bëjnë të vështirë përballjen haptazi me çështjet, siç na sugjeron edhe teologjia jonë që duhet të bëjmë.

korintasit, kanë nivele të ulëta besimi dhe refuzojnë pohimet e atyre që thonë një gjë e bëjnë një gjë tjetër. Një betejë ka nisur. Drejtuesit e krishterë nuk mund t'i gëzohen më pozicioneve autoritare. Pasja e një titulli apo e një përgjegjësie drejtuese nuk i bën më përshtypje një pjese të madhe të shoqërisë sonë. Kisha nuk po mbrun mendime dhe ide. Përkundrazi, mendimet dhe idetë e ditëve të sotme mbruhën nga një shoqëri e cila vë gjithçka në pikëpyetje, i zgjedh vlerat në mënyrë të rastësishme dhe që beson se ka të drejtë të veprojë në çfarëdo mënyre që zgjedh të veprojë. Realiteti është se një brez i tërë është i gatshëm të ketë një pamje skeptike ndaj besimit të krishterë dhe ndaj gjithçkaje që çmojmë.

Si presidenti i një shkolle biblike në Mbretërinë e Bashkuar, ky realitet më kundërvihet pothuajse çdo ditë. Të rinj e të reja të rekrutuar nga kishat, që pretendonin se kishin një dëshmi të krishterë dhe që merrnin referenca nga pastorë, vinin për vitin e tyre të parë me nivele shqetësuese të analfabetizmit biblik. Në përgjithësi, një botëkuptim biblik gjithëpërfshirës, nuk ishte i pranishëm. Ata kishin një pikëpamje të përhapur se dashuria ishte kushti i

këtij artikulli duhet t'ju ndihmojnë që t'i kundërviheni.

ARENA POLITIKO-SHOQËRORE

Zgjedhjet e fundit presidenciale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës tregojnë zhvendosje të mëdha politiko-shoqërore në një popullsi e cila ka qenë historikisht e qendrës së djathtë dhe relativisht konservatore. Ndryshimet demografike kanë ndodhur me një normë të shpejtë. Kanalet kryesore të lajmeve janë gjithnjë e më shumë përkrahëse të njëres apo tjetres palë dhe shoqëria tani është dukshëm post-e krishterë.

Sërish, kjo përfaqëson një formë delikate të luftës frymërore. Nuk bëhet fjalë thjesht për një zyrtar bashkiak që nuk bashkëpunon apo për një anëtar të vështirë të autoritetit planifikues vendor. Ky sulm politiko-shoqëror shtyhet përpara nga laicizmi i papërmbajtur, që gjen kryepërfitërinjtë e tij në organizata të cilat po respektohen gjithnjë e më shumë nga grupe të mëdha të shoqërisë sonë. Liritë civile shumë rrallë kanë lidhje me mbrojtjen e të drejtave individuale; por në mënyrë të furishme ato

janë në kundërshtim me çdo shprehje të Krishtërit. Dhe kështu që qeveria po largon të gjitha gjurmët e rrënjëve tona Judeo-Kristiane nga sheshet publike. Gjatë viteve të fundit, pavarësisht se është e qartë që shumica është kundër, zyrtarët po i heqin pllakatat që përmbajnë Dhjetë Urdhërimet nga pothuajse çdo vend publik. Beteja e ndezur rreth asaj se çfarë donin të thonin etërit themelues të shtetit amerikan kur këmbëngulën në ndarjen midis Kishës dhe Shtetit ka marrë forma të cilat themeluesit as që mund t'i kenë imagjinuar ndonjëherë. Njerëzit sot e marrin sikur ajo do të thotë çrrënjësien e të gjithë besimit nga arena publike. Askush nga etërit themelues s'e kishte menduar ndonjëherë këtë.

Dhe kjo nuk merr fund këtu. Çdo bord kishe që përpiqet të marrë iniciativë të reja në vizionin e kishës për të ndikuar pozitivisht në një komunitet, e di mirë natyrën zaptuese të legjislacionit rreth punësimit, çështjeve gjinore dhe gjëra të tjera me të cilat brezi i baballarëve tanë nuk u përball kurrë. Duke qenë se kam shpenzuar 8 vitet e fundit të jetës sime duke jetuar e punuar në Evropë, e kam parë teksa zhvillohej në mënyra edhe më flagrante këtë rend dite post-kristian dhe laik. Kisha është e margjinalizuar (shtyrë mënjanë) dhe humanizmi laik është kthyer në fenë e re të Evropës që dikur ishte e krishterë.

Ky nuk është një fenomen i ri. Duke nisur që në vitet '30 nëpër auditorët e universiteteve profesorët po shpërndanin parimet e laicizmit, pluralizmit dhe të sistemit filozofik më të gjerë të cilin sot e njohim si postmodernizëm. Rreth 30 vjet më parë, një komitet në Lozanë i identifikoi këto faktorë si prirje mbizotëruese në një shoqëri që po bëhej laike. Ajo që ndryshon tani është se këto ide, koncepte dhe mendime kanë hyrë në atë që konsiderohet normale dhe tashmë dominojnë strukturat sociale të shoqërive tona.

Do të ishte naive të supozonim se e gjithë kjo është thjesht një plan legjislativ që ka dalë pakëz jashtë kontrollit. Unë nuk kam asnjë dyshim se ligësia në vende të larta, forca demonësh dhe axhenda të fshehta kundër Krishtit janë shtysa e këtyre ndryshimeve. Si rrjedhojë, duhet t'i ballafaqojmë ato për atë që janë. Nuk do t'i zgjidhim përmes kutisë së votimit, por përmes lutjes së përbashkët, bashkësisë shumë të përkushtuar dhe përmes një gatishmërie për të dhënë jetët tona për kauzën e Krishtit.

ARENA MORALE

Megjithëse shumica e asaj që kam shkruar deri tani ka implikime të dukshme morale, është me vend të përmendim se beteja e ideve, mendimeve dhe koncepteve ka pushtuar bërthamën e karakterit

moral të shoqërisë sonë. Shoqëria e ka relativizuar pothuajse tërësisht moralitetin dhe prandaj gjithçka është e pranueshme për aq kohë sa të bën të ndihesh mirë. Kjo ka prodhuar një moralitet të individualizuar i cili është tolerant ndaj thuajse gjithçkaje dhe bashkë me të sjell kaosin e një shoqërie të shthurur e cila gjykon gjithçka, që nga heqja qafe e një fëmije që s'ka lindur ende e deri tek "vrasja" (përmes eutanazisë) e njerëzve të dobët e të pafuqishëm me mënyra pragmatike.

Për pastorët kjo do të thotë se shërbesa tani është në një kontekst ku ata nuk mund të marrin për të mirëqenë asgjë. Martesa nuk është edhe aq e vlerësuar, marrëdhëniet janë shpesh të cekëta dhe imazhet sensuale janë bërë pjesë e jetës së përditshme për shumë vetë. Është diçka e pakuptimtë dhe dritëshkurtësi të deklarojmë se ky është thjesht zhvillimi i natyrshëm i shoqërisë sonë. Pornografia është shkatërruese, i degradon gratë dhe dëmton ato familje ku ka një përkushtim të paqartë ndaj standardeve të moralit.

Ndoshta edhe më shkatërrimtare është mënyra se si shoqëria jonë e ka dëmtuar moralitetin dhe e ka bërë atë që ishte e papranueshme të jetë normalja e re. Për ata që janë në shërbesa, kjo gjë paraqet një nivel krejt të ri të luftimit frymëror. Ruajtja e zemrave tona, kujdesi për martesat tona dhe drejtimi i fëmijëve tanë është më i komplikuar sesa ishte një brez më parë. Kjo është luftë frymërore në një formë të dhunshme. Të mbajmë një përkushtim për një jetë të dëlirë, të shmangim imazhet dëmtuese që mos të na hyjnë në kokë, të jemi të përkushtuar ndaj një jetese të përgjegjshme dhe ta duam Perëndinë në atë mënyrë sa të ndikojmë në çdo fushë të jetëve tona, është një betejë në të cilën duhet patjetër të angazhohemi. Dhe, duhet të angazhohemi, ose përndryshe do ta humbasim betejën pak e nga pak, idetë kundërshtare do të fitojnë dhe misioni ynë si kripë dhe dritë do të ketë shumë pak efekt.

Më lejoni të sugjeroj katër fusha ku mund t'i angazhojmë këto shprehje të luftës frymërore:

Përkushtohuni ndaj një botëkuptimi biblik

Botëkuptim biblik do të thotë më shumë sesa thjesht të besosh që Bibla është Fjala e frymëzuar e Perëndisë. Do të thotë të zhvillosh një përkushtim të thellë ndaj sistemit gjithëpërfshirës të vlerave që përshkruhet në Bibël. Do të thotë të kesh një imagjinatë që ka lindur nga historia e shpresës, drejtësisë dhe e një të ardhmeje që është në kontrollin e plotë të Perëndisë. Gjithashtu është një kuptim i shpengimit që është thellësisht i ngulitur. E thënë ndryshe, shpresa e Perëndisë, siç u shfaq përmes punës së Krishtit me vdekjen dhe ringjalljen

e Tij, është tani në mesin tonë. Ai punon brenda nesh; Ai ndryshon jetë; Ai shëron; Ai rikthen shpresën. Një botëkuptim biblik i heq qafe pikëpamjet e dyfishta që na lejojnë të besojmë një gjë dhe të veprojmë ndryshe. Fjala dhe vepra bëhen të qëndrueshme. Ky apo kjo që jemi, jemi me anë të hirit të Perëndisë dhe kjo gjë ndikon në gjithçka, në mënyrë absolute; gjithçka çdo orë të ditës dhe çdo ditë të vitit.

Kini një botë frymërore me përvojë

Dhjata e Re flet për rolin e Frymës së Shenjtë si një kapar për atë që do të vijë më pas. Kjo do të thotë se besimi ynë ka një dimension që mbështetet në përvojë. Ne mund dhe duhet të presim një siguri të madhe të shpëtimit tonë. Kjo mund të duket si një propozim i thjeshtë, por gjithçka që ka të bëjë me jetën tonë duhet të kushtëzohet nga një përvojë e thellë dhe e brendshme e sigurisë së shpëtimit të Perëndisë dhe e së ardhmes që Ai ka planifikuar. Kjo gjë duhet të na bëjë vigjilentë ndaj veprës së djallit (1 e Pjetrit 5:8), të vendosur për t'i rezistuar sulmeve (Jakobit 4:7, 8) dhe të sigurt se mund të jemi më shumë se fitimtarë përmes Atij që na forcon (Romakëve 8:37).

Jini pjesë e një komuniteti të përkushtuar

Një ripërftyrim i kujdesshëm i kishave tona duhet të formojë një pjesë të vendosmërisë sonë për të fituar në këtë luftë frymërore. Nuk ka asgjë më të fuqishme sesa një komunitet ndjekësish të Krishtit të përkushtuar, të cilët janë të vendosur të jenë pasqyruesit e Perëndisë në botën e tyre. Shpengimi, në këto komunitete, gjen shprehjen e tij më të plotë. Njerëzit kujdesen për njëri-tjetrin, i shërbejnë njëri-tjetrit dhe qëndrojnë përkrah njëri-tjetrit në çdo betejë. Kjo është ndoshta arsyeja se përse apostulli Pal ishte shumë i drejtpërdrejtë në letrën e tij drejtuar kishës në Korint. Një kishë që humbet qëllimin e saj shpengues bëhet e pafuqishme nga sulmet që njerëzit hasin çdo ditë. Humbet lidhjen që duhet të ketë me brezin e ardhshëm. Nëse ky artikull do të ndizte ndonjë shkëndijë interesi në luftën frymërore të përmbledhur tek idetë, mendimet dhe konceptet, atëherë duhet të ndezë po ashtu një shkëndijë angazhimi me kishën e Jezus Krishtit.

Zhvilloni një dashuri për të varfrit

Për ta thënë këtë me pak më shumë ngjyrim teologjik, një element strategjik i luftimit tonë frymëror duhet të jetë një kuptim i drejtësisë i zhvilluar mirë. Një shërbim jo i singertë e mospërfillës ndaj misionit

na lë të pafuqishëm. Por kthimi i misionit në fokusin kryesor të jetës sonë, na bën të guximshëm, na forcon nga përbrenda dhe na pajis për t'u përballur në mënyrë më të informuar me sulmet frymërore. Dashuria e Perëndisë për të vejat, jetimët dhe të varfrit duhet të frymëzojë çdo aspekt të mënyrës sesi jetojmë. Dhe kjo më pas, do të na bëjë vigjilentë ndaj botës frymërore në një mënyrë që nuk është e lehtë për t'u kopjuar diku tjetër. Personat më vigjilentë nga ana frymërore që unë njoh janë që kanë një përkushtim të zhvilluar mirë ndaj të varfërve. Ata janë më vigjilentë, të pajisur më mirë për luftën frymërore dhe dukshëm më fitimtarë si ndjekës të Krishtit.

MENDIME PËRMBYLLËSE

Shpresoj që ky artikull do ta zgjerojë diskutimin rreth luftës frymërore. Jemi duke u përballur me forca të liga frymërore në çdo front. Drejtuesit, pastorët, prindërit dhe të krishterët në përgjithësi duhet ta stërvitin veten e tyre në përdorimin e armëve tona të cilat nuk janë, siç na e kujton edhe Fjala e Perëndisë, të mishit, por janë të fuqishme përmes Perëndisë për rrëzimin e këtyre fortesave (2 Korintasve 10:4).



PAUL ALEXANDER, Ph.D.,
President i Kolegjit Biblik Triniteti
(Trinity Bible College), Ellendejl,
Dakota e Veriut





Botëkuptime

dhe Bota e Padukshme

Nga: **TERRY HANNA**

Një botëkuptim i deformuar është i rrezikshëm dhe shumë pak i qëndrueshëm ndaj mashtrimit djallëzor. Megjithatë, një botëkuptim i formuar mirë, i rrënjosur në të vërteta biblike, i aftëson besimtarët ta njohin aktivitetin djallëzor dhe të kenë ndikim në reagimet e tyre ndaj botës së padukshme.

Kur mbërrita në shtëpinë e një anëtari të vjetër të kishës pentekostale, e pashë atë tek më bënte shenjë me dorë për të shkuar në pjesën e pasme të shtëpisë. Prej aty, më drejtoi për të hyrë në shtëpi nga dera e pasme, duke më shpjeguar se një “taotaomona” (frymë e paraardhësve) ishte transferuar në pemën që ishte para shtëpisë dhe ai nuk donte që ta mërziste atë. Sipas traditës, “taotaomonat” janë shpirtrat e paraardhësve të lashtë të banorëve të Guamit dhe ata banojnë në xhunglat e Guamit. Ky person ishte një anëtar besnik i kishës dhe instinkti im i parë ishte të mendoja: “Po si ka mundësi që ky të jetë kaq supersticioz?”. U lutëm dhe unë u largova, aspak i bindur se tani ai kishte më pak frikë.

Ndërsa reflektova mbi këtë me kalimin e viteve, kuptova që frika e tij vinte nga një botëkuptim që përfshinte mbetje të animizmit të cilat ai nuk i kishte ballafaquar kurrë nga ana biblike në atë mënyrë që të depërtonte në perceptimet e rrënjosura thellë në botëkuptimin e tij. Në të njëjtën kohë, perspektiva e botëkuptimit tim, e ndikuar nga arsyetimi perëndimor, shtyu qëndrimin tim fillestar refuzues duke mos e pranuar shqetësimin e tij ndaj besëtytnive. Që të dy përjetuam një ngjarje përmes lenteve të botëkuptimeve, të cilat nuk ishin në një linjë me botëkuptimin biblik i cili i adresohet robërisë ndaj botës së padukshme.

Kjo përvojë nënvizon rrezikun e botëkuptimeve që nuk janë të rrënjosura tek Bibla. Madje, ajo tregon nevojën që ekziston për një botëkuptim të formuar mirë që të kundërshtojë botëkuptimet konkurruese dhe mënyrën se si ato ndikojnë tek reagimet ndaj botës së padukshme.

FUQIA E BOTËKUPTIMEVE PËR T'I DHËNË FORMË MËNYRËS SE SI E SHOHIM BOTËN FRYMËRORE

Botëkuptimet janë mënyrat sesi ne e kuptojmë botën. Ndryshe i përshkruajmë ato si “ajo me të cilën shohim, dhe jo ajo të cilën shohim”.¹ Botëkuptimet janë si shikimi përmes një palë syzesh të cilat e qartësojnë atë që shohim dhe e bëjnë më të kuptueshme. Botëkuptimi i secilit është unik, edhe pse mund t'i përngjajë pikëpamjeve të familjes së tij ose të saj, për shkak se formimi i botëkuptimit fillon pikërisht në shtëpi, ku personi thith qëndrimet, vlerat dhe besimet kulturore të prindërve. Zhvillimi i mëtejshëm i botëkuptimit ndodh përmes përvojave, përplasjeve fetare, ndikimeve të medias dhe marrëdhënieve. Megjithatë, faktori kryesor në formimin e botëkuptimit individual është mënyra mbizotëruese sesi e sheh botën kulturore ku jemi rritur. Edhe pse ai miku im nuk ishte animist, traditat e vjetra animiste të cilat merreshin me botën e padukshme ishin ende të pranishme dhe ndikonin në pikëpamjen e tij personale. Mënyra sesi amerikanët ose evropianët e shohin botën e padukshme ndikon në botëkuptimin e tyre personal. Modelet e botëkuptimeve që ndikojnë botëkuptimin tonë personal përfshijnë këto si më poshtë:

1. Botëkuptimi natyralist. Ky është një botëkuptim kryesor perëndimor i cili e mohon ekzistencën e një bote frymërore, duke këmbëngulur se ekziston vetëm ajo materiale. Me anë të këtij botëkuptimi, njerëzit e bazojnë natyralizmin mbi metodat shkencore, të arsyeshme dhe ne nuk mund ta vërtetojmë në mënyrë të arsyeshme botën frymërore. Natyralizmi ndan “të mbinatyrshmen nga realiteti i natyrshëm, Perëndinë nga natyra dhe fenë nga shkenca”.² Ai e sheh botën materiale si një makineri pa shpirt, ku mungon Perëndia, pa një arsye ose qëllim hyjnor dhe njerëzimi është thjesht pjesë e natyrës, i barabartë me botën shtazore.³ Njerëzimi, për shkak të mosbesimit të tij tek bota frymërore ose tek jeta pas vdekjes, kthehet në arbitrin e çdo gjykimi moral. Botëkuptimet laike amerikane dhe evropiane janë një produkt i këtij koncepti natyralist të realitetit.⁴

2. Botëkuptimi animist. Ky botëkuptim ndikoi në mënyrën sesi e shihte miku im botën e padukshme. Zakonisht animizmi e ka një lloj perëndie krijues si qendër, por theksi qëndron mbi një mori qeniesh frymërore të cilat popullojnë botën dhe ndërveprojnë

me njerëzimin.⁵ Këto frymëra, sipas traditave folklorike, sjellin fat të mirë ose të keq, vuajtje dhe sëmundje.⁶


3. Botëkuptimi biblik. Ungjillorët amerikano-veriorë dhe pentekostalët në përgjithësi dëshmojnë se pikëpamja e duhur e jetës është përmes lenteve të Biblës. Termi ‘botëkuptim biblik’, në një kuptim të përgjithshëm, përshkruan sesi Bibla është zbulesa që Perëndia i bën vetes së tij, natyrës së tij trinitare (tre në një), krijimit, planit të tij të mishërimit dhe shpengimit dhe banimit të Frymës së Shenjtë brenda nesh.⁷ Pentekostalizmi i shton kësaj edhe një lente hermeneutike (teoria e interpretimit të teksteve biblike), përmes së cilës e kuptojmë botëkuptimin biblik në një mënyrë edhe më personale. Ndërsa në kuptimin më specifik, duam që botëkuptimet personale të fillojnë të rreshtohen me të vërtetën biblike që nga momenti që rilindim.

E vërteta biblike ballafaqohet me botëkuptimin tonë të vjetër ndërkohë që Perëndia na shfaqet, duke i sfiduar kështu botëkuptimet tona ekzistuese në një proces, të cilin Riçard Nibër (Richard Niebuhr) e përshkruan si një gjendje “revolucionit të përhershëm”.⁸ E vërteta biblike sfidon supozimet tona dhe ne përgjigjemi duke i vënë në një vijë perceptimet tona me zbulesat biblike, të ndihmuar nga Fryma e Shenjtë e cila na udhëheq “në gjithë të vërtetën” (Gjoni 16:13). Prandaj, kur flasim për botëkuptime të mirë-formuara, e kemi fjalën për botëkuptime personale të cilat i ngulisim fort në të vërteta biblike. Ky është një proces i vazhdueshëm ndërkohë që e vërteta e re biblike rrënjësohet thellë në perceptimet e botëkuptimit tonë.

4. Botëkuptimi hibrid. Problemet e botëkuptimit që unë edhe miku im hasëm, ishin si rezultat i zonave të cilat nuk i kishim ballafaquar plotësisht në nivelin e botëkuptimit. Pikëpamja e tij e krishterë për botën kishte mbetje të mënyrës së vjetër të të parit të botës së padukshme, që shkaktonte robëri ndaj frikës. Unë rashë në arsyetimin e botëkuptimeve laike të Amerikës Veriore dhe arsyetova merakun e mikut tim ndaj besëtytnive. Shërimi për një pështjellim të tillë është një botëkuptim i mirë-formuar, ndërkohë që një botëkuptim i deformuar nuk arrin ta shohë nevojën ose të përgjigjet me siguri biblike, duke i lënë njerëzit në robëri.

BOTËKUPTIMET E DEFORMUARA DHE AKTIVITETI DJALLËZOR

Njerëzit me botëkuptime të deformuara mashtrohen lehtësisht në lidhje me natyrën e aktivitetit djallëzor



dhe kanë prirjen që të kërkojnë ndihmë nga burimet e gabuara për shkak të natyrës mashtruese të Satanit. Satani është një gënjeshtar, babai i gënjeshtreve dhe gënjeshtërën ai e “flet nga vetvetja” (Gjoni 8:44); demonët janë “frymëra mashtruese” (1 Timoteut 4:1). Dejvid Nogëll (David Naugle) shkruan rreth mundësisë që kanë botëkuptimet kulturore mbizotëruese për të ndihmuar me mashtrimin nga demonët: “Duke qenë se Satani dhe demonët mund t’i manipulojnë meshkujt dhe femrat deri në pikën që janë të mashtruar, atëherë a mund të ketë mënyrë më të mirë për ta bërë këtë sesa duke përhapur koncepte të rreme të realitetit përmes kanalit të frymës së kësaj epoqe?”⁹

Një shembull i gjallë se si botëkuptimet e deformuara i interpretojnë ngjarjet në mënyra të cilat kontribuojnë në mashtrimet djallëzore na vjen nga një burrë, bashkëshortja e të cilit besonte se fryma e një të vdekuri nga varrezat e qytetit e torturonte atë mendërisht për 6 vjet. Doktorin nuk mund të gjente asnjë problem nga ana fizike, ndërkohë që ajo ra në peshë dhe mbeti pa fëmijë dhe nuk kishte asnjë

13 deri në 19 vjeç dhe zbuloi se 19 për qind e tyre ishin plotësisht dakord që njerëzit mund të komunikojnë me të vdekurit; 10 për qind thanë se ata personalisht komunikonin me një person të vdekur; 73 për qind besojnë në një botë të mbinatyrshme; 35 për qind përdornin tabelën “Ouija” (një tabelë me shkronjat e alfabetit, numrat 0-9, dhe disa fjalë të shkurtra që përdoret për të komunikuar me shpirtrat); 79 për qind shikonin horoskopin; 30 për qind këshilloheshin me një fallxhore që lexon dorën.¹⁰

Një pjesë e këtij realiteti mund të jetë si produkt i kureshtjes së të rinjve, por gjithashtu tregon edhe llojin e informacionit jobiblik me të cilin mbushen mendjet e të rinjve. Media paraqet mënyra alternative për t’u përballur me problemet përmes televizionit, filmave, lojërave elektronike dhe librave të cilët i paraqesin fantazmat, demonët, shtrigat, njerëzit-ujqër dhe vampirët si personazhe të dhimbsur që ndihmojnë njerëzimin. Një tjetër faktor që kontribuon në bërjen e botëkuptimeve të cënueshëm ndaj mashtrimit djallëzor është një analfabetizëm teologjik në rritje. Një studim i vitit 2010 i grupit Barna, zbuloi



Njerëzit me botëkuptime të deformuara mashtrohen lehtësisht në lidhje me natyrën e aktivitetit djallëzor dhe kanë prirjen që të kërkojnë ndihmë nga burimet e gabuara për shkak të natyrës mashtruese të Satanit.

këshillues për të parë se çfarë problemesh të tjera mund të ekzistonin. Bashkëshorti dhe familja e tij ishin të krishterë sa për emër, por botëkuptimi i tij ndikoi në një reagim të bazuar mbi njohuritë tradicionale dhe jo mbi të vërtetën biblike. Si rezultat, ai hapi varrin e burrit që ai mendonte se ishte fryma fajtores dhe i sulmoi eshtrat me një thikë ndërkohë që bërtiste me të madhe duke e kërcënuar se do i shkatërronte skeletin nëse nuk t’i jepte fund shqetësimeve që po i shkaktonte të shoqes. Botëkuptimi i këtij bashkëshorti ndikoi në gënjeshtërën që kishte rreth natyrës së problemit të bashkëshortes së tij, si edhe në reagimin nga burime jobiblike.

Kjo histori vjen nga një vend ishullor në Paqësor. Disa persona mund të thonë se kjo histori ndodhi atje, por nuk mund të ndodhë kurrë në vendin tim. Edhe pse ky reagim me bazë animiste nuk mund të ndodhë këtu, ajo që mund të ndodhë është kërkimi i ndihmës nga burime jobiblike. Një raport i vitit 2006 rreth Amerikës së Veriut nënvizon faktin se qasja ndaj burimeve jobiblike është një problem në rritje. Ky studim testoi 4.340 adoleshentë të moshave nga

se analfabetizmi biblik është një tendencë në rritje dhe që “ideja teologjike ‘falas për të gjithë’, e cila po i kalon kufijtë në kishat protestante, të sugjeron se dekada e ardhshme do të jetë një periudhë me larmi dhe mospërputhshmëri të pakrahasueshme teologjike”.¹¹ Kjo është në të njëjtën linjë me një analizë tjetër të 20 viteve (1991 – 2001) e cila zbuloi një zhvendosje në rënie të besimit se “Bibla është plotësisht e saktë në të gjitha parimet që ajo mëson” nga 46 në 38 për qind.¹²

Botëkuptimet laike dhe ato të tjera do të mbushin hendekun për njerëzit në të gjitha kombet ndërsa ata mundohen të kuptojnë botën e padukshme. Si mund të presim që fëmijët dhe adoleshentët tanë t’i menaxhojnë këto lloj gjërash nëse nuk ka asnjë mësim teologjik ose baza mbi të cilat të mund të formojnë botëkuptime në lidhje me botën e demonëve? Kisha duhet ta marrë “seriozisht aspektin trinitar të Perëndisë, i cili është vazhdimisht i përfshirë në krijimin e Tij me anë të kujdesit të Tij hyjnor, prezencës dhe fuqisë së Tij, ... Duhet ta marrë Satanin dhe demonët seriozisht, sepse janë

engjëj të rënë që kërkojnë t'i pengojnë njerëzit që të kthehen tek Perëndia në pendim, besim dhe në bindje ndaj Tij”.¹³ Kisha duhet të jetë e ndërgjegjshme se botëkuptimet e deformuara i bëjnë njerëzit të cënueshëm ndaj mashtimit dhe skllavërisë së demonëve, por botëkuptimet e mirë-formuara e dallojnë burimin e vërtetë të ndihmës.

BOTËKUPTIMI I MIRËFORMUAR NA VENDOS NË NJË VIJË ME TË VËRTETËN BIBLIKE

Botëkuptimet e mirëformuara reagojnë ndaj botës së frymës përmes përgjigjeve të rrënjësura në Bibël të cilat tregojnë natyrën e mbretërisë së Perëndisë. Xhorxh Lad (George Ladd) e përshkruan realitetin dhe fuqinë që lidhet me mbretërinë e Perëndisë duke thënë se Mbretëria “tashmë e ka mposhtur fuqinë e vdekjes, ka mundur Satanin dhe e ka përmbysur sundimin e mëkatit”.¹⁴

Këtë gjë Luka e demonstroi në një histori që bën fjalë për një grua me një dhimbje kronike që i kishte shkaktuar shtrembërim në shtyllën kurrizore (Luka 13:10-17). Edhe pse Jezusi iu referua shkakut si një “frymë lëngate” (vargu 11), Ai nuk e trajtoi si një përballje tradicionale me demonë dhe as nuk është një histori tipike shërimi. Gjithashtu, vendi ku ndodh ngjarja (në sinagogë) e lidh këtë histori me shpalljen e madhe të Jezusit për Mbretërinë (Luka 4:18, 19) dhe është një hyrje e mësimave të Tij rreth Mbretërisë tek Luka 13:18-21.¹⁵ Përmes kësaj historie, ne shohim kontrastet midis një botëkuptimi biblik dhe një botëkuptimi tjetër. Kur njerëzit e ndikuar nga një botëkuptim laik e shohin gruan, ata përqendrohen tek sëmundja dhe duan të dinë llojin, origjinën e sëmundjes dhe kurat e mundshme të saj. Botëkuptimi i ndikuar nga animizmi dëshiron të dijë se cila frymë e shkaktoi problemin. A nuk respektoi frymën e ndonjë paraardhësi dhe a u mundua të zbuste atë? Megjithatë, në këtë histori gjejmë një tjetër botëkuptim. Përgjigja e Jezusit na tregon se fokusi i Tij ishte tek gruaja që ishte në skllavëri dhe ai thjesht tha: “O grua, ti je e liruar nga lëngata jote” (Luka 13:12). Përgjigja e tij tregon se natyra dhe burimi i lëngatës nuk ishin fokusi i Tij kryesor. Fokusi i tij ishte personi që ishte në zgjedhje dhe dëshira e Tij për të sjellë çlirimin e Mbretërisë, “çlirimin e të burgosurve dhe kthimin e të parit të verbërve, për të dërguar në liri të shtypurit” (Luka 4:18).

Një bisedë që pata me një pentekostal nga ishujt e Paqësorit ilustron pikërisht këtë këndvështrim biblik. Para disa vitesh ai kaloi përmes një konvertimi dhe një transformimi botëkuptimor dramatik kur pa motrën e tij të çlirohej nga, siç tha ai, vite skllavërie nga demonët. Ajo hidhej dhe përplasej në dysheme, fliste në mënyrë të pakuptueshme e në zë të ndryshëm dhe përpiqej të lëndonte veten e saj. Nga

perspektiva e botëkuptimit të familjes së saj, atë e kishte pushtuar një frymë e ligë, ndërsa dikush që kishte një botëkuptim laik mund ta konsideronte atë si një lloj krize epileptike. Megjithatë, xhaxhai i tyre pentekostal mbërriti gjatë një prej krizave të saj. Kur ai u lut për të, i urdhëroi demonët – jo frymërat e të vdekurve apo çrregullimet mendore të natyrshme – që të largoheshin dhe të mos ktheheshin më kurrë. Vëllai i saj tha se ndryshimi ishte i menjëhershëm dhe i përhershëm dhe për shkak të kësaj, e gjithë familja u kthye tek Jezusi. Vëllai më tha: “Unë besoj tek Perëndia dhe tek ungjilli dhe kjo më ndryshoi këndvështrimin tim. Më ndryshoi jetën dhe nuk më duhet të jem i mbushur me frikë nga forcat frymërore. Unë besoj se ato nuk kanë absolutisht asnjë autoritet apo fuqi për të ndërhyrë në jetën time”. Në këtë rast, si botëkuptimi animist, edhe ai laik ishin të pavend ndaj dëshpërimit të kësaj vajze. Xhaxhai, me një botëkuptim të transformuar, e njohu skllavërinë e saj përmes një fryme dallimi dhe ajo fitoi çlirimin e Mbretërisë.

TË TRANSFORMOJMË BOTËKUPTIMIN TONË

Kohët e fundit kam qenë i përfshirë në një projekt hulumtimi të projektuar për të identifikuar faktorët që kontribuojnë në transformimin e botëkuptimeve tek besimtarët, veçanërisht në fushën e botës së padukshme. Nga hulumtimi dolën pesë faktorë me rëndësi globale. (1) Një përbërës i fortë frymëror që përfshinte konvertimin dhe pagëzimin në Frymë, së bashku me një jetë të përkushtuar të disiplinuar; (2) Mësimi i Fjalës së Perëndisë; (3) Mentorë të perëndishëm ndihmuan duke dhënë mësim, duke inkurajuar dhe duke shfaqur sjellje të duhura në sytë e tyre; (4) Marrëdhëniet ishin burime inkurajimi dhe përforcimi për ato që kishin mësuar dhe përjetuar; (5) Përvoja praktike në shërbesë e shtoi atë që kishin mësuar.

© 2009 Paul F. Gray



Kur i thashë pastorit që do të doja pak më shumë mish në predikimet e tij, ai më pyeti se mos doja dhe ca patate të skuqura”.

Ishte e qartë që kishat ishin një pjesë e domosdoshme e procesit në tërësi. Kishat ndihmojnë në zhvillimin e botëkuptimeve të rrënjësura biblikisht atëherë kur ato:

- ❖ Janë të ndjeshme nga ana frymërore ndaj pranisë së Frymës së Shenjtë dhe praktikojnë adhurim pentekostal dhe aktivitete karakteristike pentekostale, të cilat janë të favorshme për të sjellë ndryshim.
- ❖ Japin mësim teologjik biblikë mbi çështjet e jetës, duke përfshirë një teologji të botës së padukshme dhe të mbretërisë së Perëndisë. Ky ishte udhëzimi i Palit për Timoteun: “Porosit këto gjëra dhe mëso këto gjëra” (1 Timoteut 4:11) dhe për Titin: “Por ti fol ato që i kanë hije doktrinës së shëndoshë” (Titit 2:1).
- ❖ Mentorojnë njerëz duke përdorur besimtarë të perëndishëm dhe të përkushtuar të cilët janë zotuar për të zhvilluar një botëkuptim biblik. Priskila dhe Akuila e morën Apollon në shtëpinë e tyre dhe “ia shtjelluan më saktë udhën e Perëndisë” (Veprat e Apostujve 18:26), duke e ndihmuar atë të transformonte këndvështrimin e tij mbi Rrëshajën.
- ❖ Aftësojnë ndërtimin e marrëdhënieve. Marrëdhëniet i inkurajojnë njerëzit (Hebrenjve 10:24, 25). Besimtarët e hershëm ndërtuan marrëdhënie transformuese ndërsa ndanë me njëri-tjetrin adhurimin, vaktet, lutjet dhe madje edhe të mirat materiale (Veprat e Apostujve 2:42-46; 4:32-37).
- ❖ Ofrojnë mundësi për shërbesa praktike të cilat përforcojnë dhe konsolidojnë botëkuptimet e ndryshuara të individëve. Jezusi përfshiu në shërbesë të Dymbëdhjetët (Mateu 10:1-16; Marku 6:7-13; Luka 9:1-9) dhe Shtatëdhjetët e Dy ndjekësit (Luka 10:1-10).

PËRFUNDIMI

Botëkuptimet e deformuara janë të cënueshme ndaj mashtrimit djallëzor dhe i bëjnë njerëzit të kërkojnë ndihmë nga burimet e gabuara. Mirëpo, botëkuptimet e mirë-formuara, të rrënjësura në të vërtetat biblike, i aftësojnë besimtarët ta dallojnë aktivitetin e demonëve dhe t'i perceptojnë të tjerët që janë në skllavëri për të sjellë çlirimin e Mbretërisë. Kisha është jetësore për një transformim tërësor që përfshin aktivitetin frymëror, mësimdhënien, mentorimin, ndërtimin e marrëdhënieve dhe shërbesën praktike.

Në fillim të artikullit, nëse unë dhe miku im do ta kishim parë atë që po ndodhte përmes lenteve të një botëkuptimi më të përqendruar në Bibël, atëherë ai do të kuptonte se nuk kishte asnjë arsye për të pasur frikë nga bota e padukshme dhe do të kishte qëndruar i patundur për shkak të perceptimeve të tij botëkuptimore të mbretërisë së Perëndisë. Edhe unë po ashtu, do ta kisha kuptuar më mirë robërinë e tij

nga frika e botës së padukshme dhe do të kisha qenë më proaktiv për të sjellë çlirimin e Mbretërisë. Nga e gjithë kjo mund të marrim me vete thelbin e këshillës transformuese të Palit: “Mos u konformoni me këtë botë, por transformohuni me anë të ripërtëritjes së mendjes suaj, që të provoni cili është i miri, i pëlqyeri dhe i përsosuri vullnet i Perëndisë” (Romakëve 12:2).



TERRY HANNA, Springfield, Missouri, punon me zyrën e Asia Pacific Harvest në Rajonin e Paqësorisë Aziatik.

Shënime

1. Paul G. Hiebert dhe Eloise Hiebert Meneses, *Incarnational Ministry: Planting Churches in Band, Tribal, Peasant, and Urban Societies* (Grand Rapids: Baker Academic, 1995), 41.
2. Paul G. Hiebert, R. Daniel Shaw, dhe Tite Tiénou. “Responding to Split-Level Christianity and Folk Religion” in *International Journal of Frontier Missions* 16, no. 4 (winter 1999/2000), 175.
3. James W. Sire, *The Universe Next Door: A Basic Worldview Catalog* (Downers Grove, Illinois: InterVarsity Academic Press, 2009 [1976]), 66–143.
4. Gary W. Phillips, William E. Brown, dhe John Stonestreet, *Making Sense of Your World: A Biblical Worldview* (Salem, Wisconsin: Sheffield Publishing Company, 2008), 24–32.
5. Charles H. Kraft, *Worldview for Christian Witness* (Pasadena: William Carey Library, 2008) 241–42; 481–90.
6. Gailyn Van Rheenen, *Communicating Christ in Animistic Contexts* (Pasadena: William Carey Library, 1991), 58, 59.
7. Phillips et. al. 96–101.
8. Loder, 19.
9. David K. Naugle, *Worldview: The History of a Concept*, (Grand Rapids: William B. Eerdmans Publishing Company, 2002), 283.
10. David Kinnaman, *Teens and the Supernatural* (Ventura, California: The Barna Group, 2006), 15–27.
11. The Barna Group. “Six Megathemes Emerge from Barna Group Research in 2010.”
12. The Barna Group. “Barna Examines Trends in 14 Religious Factors Over 20 Years (1991 to 2011).”
13. Hiebert, Shaw, and Tiénou, 174.
14. George Eldon Ladd, *The Gospel of the Kingdom: Scriptural Studies in the Kingdom of God* (Grand Rapids: William B. Eerdmans Publishing Company, 1959), 130.
15. Ned B. Stonehouse, F.F. Bruce, dhe Gordon D. Fee, eds., *The Gospel of Luke. The New International Commentary on the New Testament*, by Joel B. Green (Grand Rapids: William B. Eerdmans Publishing Company, 1997), 518–21.

Të Sjellim Ndikim Mbi Komunitetet Ku Jetojmë

Për Lordinë e Krishtit!

Nga: **FATJON KADIU**

Por ju jeni fis i zgjedhur, priftëri mbretërore, një komb i shenjtë, një popull i fituar, që të shpallni mrekullitë e Atij që ju thirri nga terri në dritën e Tij të mrekullueshme.

1 Pjetrit 2:9

Zoti dëshiron që të shfaqë veten përmes kishës së Tij. Ndikimi që një kishë lokale mund të ketë mbi komunitetin ku ajo ekziston mund të jetë vërtet i madh. Jo domosdoshmërisht duhet të jesh një kishë e madhe, që të kesh një impakt të madh. Ne e kemi parë këtë në kishën tonë “Lajmi i Mirë”, në Fier.

Kemi ndjerë thirrjen e Frymës së Zotit për të dalë jashtë mureve të kishës dhe për të ndriçuar dritën e Tij aty ku janë të humburit, ata që ecin në errësirë frymërore, ata që janë pa shpresë. Në fakt, vendi i çdo kishe është jashtë mureve të ndërtesës dhe kisha duhet të jetë e dukshme përmes fuqisë së Frymës së Shenjtë në komunitet. Zoti Jezus tha se një qiri nuk ndizet për ta vënë nën babunë, por mbi shandan. Sapo e kemi ndjerë thirrjen e Zotit kemi kërkuar Zotin intensivisht në lutje si kishë për dyer të hapura, për lidhjet e duhura dhe për kohën e duhur. Kemi kërkuar për mundësi dhe dyer të hapura se ku mund të shërbejmë. Dyert që Zoti ka hapur kanë qenë të shumta.

Përmes dhuratave të fëmijëve të organizatës “Samaritan Purse” në vitin 2013, u mobilizuan si kishë dhe iu shpërndamë dhurata fëmijëve në

dhjetëra shkolla brenda dhe jashtë Fierit. Ishte një mundësi e artë për të ndarë Lajmin e Mirë me nxënësit dhe mësuesit. Pothuajse në të gjitha shkollat ku shkua, ndamë lirisht ungjillin me ta. Madje në disa shkolla, drejtori na kërkoi t’u flisnim mësuesve për ungjillin. Ishte një kohë e bekuar për kishën sepse vetë besimtarët u bekuan shumë ndërsa shërbenin. Në atë periudhë kemi ndarë ungjillin me rreth 4500 fëmijë dhe rreth 100 mësues. Lavdi Perëndisë! Ai mund të bëjë gjëra madhështore përmes kishave “të vogla”.

Po në këtë vit Zoti hapi një derë tjetër për kishën tonë. Përmes një partneriteti të bekuar e të frytshëm me kishën “Abundant Life” në Minnesota, kemi pasur disa fushata ndërgjegjësimi për të mbajtur pastër mjedisin ku jetojmë. Ka qenë një bekim të dilnim e t’i shërbenim komunitetit duke pastruar mbeturinat në lagje të ndryshme. Shumë njerëz na pyesnin pse e bënim dhe kjo ishte mundësi e mirë të flisnim me ta e t’u tregonim se kush ishim dhe çfarë na motivonte.

Disa të tjerë u bashkuan me ne për të pastruar. Këto fushata u pasqyruan në mediat lokale dhe ishte bekim të ndanim ungjillin edhe përmes mikrofonit të medias.



Kemi parë një nevojë të madhe në fshatin Drizë, në periferi të Fierit, një fshat me popullsi të komunitetit Rom. Kur kemi shkuar në këtë fshat herët e para mund ta ndjeje tensionin, errësirën dhe rezistencën frymërore. Njerëzit ishin të pashpresë e mosbesues. Ishte një territor i pashkelur nga një kishë ungjillore më parë. Ishte një territor të cilin armiku e kishte si fortesë të tijën. Menjëherë jemi mobilizuar në lutje ndërmjetësuese intensive me një grup vëllezërisht e motrash të kishës. Kemi filluar të punojmë përmes programit



të shkollimit të fëmijëve në një partneritet me organizatën Fida, ku fillimisht përfshimë 25 fëmijë. Më pas kemi vizituar çdo familje të fshatit shtëpi më shtëpi dhe kemi ndarë me ta dashurinë e Zotit. Filluam shërbesa të rregullta fëmijësh ku ishim të pranishëm dy herë në javë. Më pas numri i fëmijëve u dyfishua në 50 dhe kjo do të thotë një ndikim të vazhdueshëm në rreth 50 familje të komunitetit me ungjillin. Janë rreth 12 persona të rritur që kanë pranuar Krishtin dhe rreth 100 fëmijë që dëgjojnë rregullisht ungjillin. Atje tani ka shërbesa të rregullta fëmijësh. Lavdi Zotit! Sot, pas tre vjetësh, kur kthejmë kokën pas, shohim një realitet tjetër në atë fshat. Tani është shumë e lehtë të ndash ungjillin në atë komunitet. Drita e ungjillit ka shpërndarë retë e errësirës dhe shtypjes frymërore.

FATJON KADIU, Pastor,
Kisha "Lajmi i Mirë", Fier



Gjithashtu për lavdinë e Perëndisë, në vitin 2012, kisha "Lajmi i Mirë" hapi kopshtin e parë të krishterë në Fier. Në rrethanat dhe mundësitë e kishës tonë ishte e pamundur, por e dinim se ishte koha e duhur atë vit. Shumë familje myslimane dhe jobesimtarësh sollën fëmijët dhe mbetën të kënaqur. Ndikimi i kopshtit ka qenë shumë i madh. Në fakt na është dukur sikur kisha ka qenë në një



cep të fshehur e tani doli në dritë dhe gjithë komuniteti mund ta shihte. Tri familje iu shtuan kishës përmes shërbesës së kopshtit dhe të tjera familje morën ungjillin.


Lavdi Perëndisë! Perëndia vërtet bën gjëra të mëdha përmes kishave "të vogla". Një kishë që lutet dhe kërkon Zotin është edhe një kishë aktive. Ne jemi në këtë tokë për të shpallur veprat e Tij të mrekullueshme, derisa Krishti të kthehet.

“| zíní dhelpirat, dhelpirat e vogla që
dëmtojnë vreshtat, sepse vreshtat tanë
janë në lulëzim”.

Kënga e Këngëve 2:15

A photograph of three young foxes (cubs) standing on a light-colored dirt mound. They have reddish-brown fur with white underparts and black-tipped tails. They are looking directly at the camera. The background is filled with dense green foliage.

*D*helpirat



Një dhelpër që futet vjedhurazi në një vresht është jashtëzakonisht e dëmshme. Rojtarët e vreshtit e konsiderojnë dhelprën si një nga armiqtë më të mëdhenj të vreshtit. Dhelprat nuk hanë vetëm mishin, por gjithashtu edhe mjaltin dhe frutat, veçanërisht rrushin. Dhelprat ishin shumë të përhapura në Palestinë dhe e bënë strofkën në të çarat që ishin në gardhin që rrethonte vreshtin. Kur rrushi është akoma i papjekur dhe i njomë, dhelprat e vogla hyjnë fshehurazi në vresht, kapin pjergullën dhe e ulin atë poshtë duke e ngrënë dhe duke e prishur rrushin; dhe, nëse nuk ruhen me rreptësi, dhelpra mund të shkatërrojë vreshta të tërë. Në jetët dhe zemrat tona ka “dhelpra të vogla” dinake të cilat futen vjedhurazi. Dhe ndodh që ne nuk jemi edhe aq syçelë ndaj asaj që po ndodh në fakt, deri kur dëmi të jetë bërë.

Nga: **MARCIA LEDNICKY**

e Vogla

Shumë është shkruar për “Luftën Frymërore” dhe ajo është diçka me të cilën përballet vazhdimisht çdo besimtar. Tek Galatasve 5:17 thuhet: *“sepse mishi ka dëshira kundër Frymës, dhe Fryma ka dëshira kundër mishit; dhe këto i kundërvihen njëra-tjetrës, që të mos bëni ato që doni”*. Në fakt, nëse e lexojmë të gjithë këtë kapitull, kujtojmë dëshirat e shumta të natyrës mëkatore në krahasim me frytin që prodhohet në jetët tona me anë të Frymës së Shenjtë. Tek vargu 24 thuhet: *“Por ata që janë të Krishtit e kanë kryqëzuar mishin bashkë me pasionet dhe epsheet”*. Kapitulli mbyllet (në vargun 26) me këtë fjali: *“Le të mos kërkojmë lavdi të kotë, duke provokuar njëri-tjetrin dhe duke pasur smirë njëri-tjetrin”*. Ndërsa i lexoj këto vargje, duket qartë që “dhelprat e vogla” mund të hyjnë fshehurazi shumë kollaj në jetët e atyre që janë në shërbesë dhe në martesën tonë të çmuar.


Fjala e Perëndisë na jep udhëzime se si ta fitojmë këtë betejë. Tek Efesianëve 6:11-14 thuhet: *“Vishni gjithë armatimin e Perëndisë që të mund të qëndroni kundër dredhive të djallit, sepse beteja jonë nuk është kundër gjakut dhe mishit, por kundër principatave, kundër pushteteve, kundër sunduesve të përbotshëm të errësirës së kësaj jete, kundër frymërave të liga në vendet qiellore. Prandaj merrni të gjithë armatimin e Perëndisë, që të mund të rezistoni në ditën e ligë dhe të qëndroni në këmbë pasi të keni kryer çdo gjë. Qëndroni, pra, të fortë, duke ngjeshur mesin tuaj me të vërtetën, të veshur me parzmoren e drejtësisë”*.

Ndërkohë që Pali ishte në burg në Romë, ai u shkroi besimtarëve në Filipi një letër medituese shumë personale, ku theksohej rëndësia dhe ngutësia që besimtarët të jetonin në një mënyrë që ngre Krishtin lart dhe lavdëron Perëndinë në çdo kohë. Tek Filipianëve 1:27 thuhet: *“Ju veç, silluni denjësisht ndaj ungjillit të Krishtit”*. Sot në botën tonë moderne dëgjojmë shumë njerëz që thonë: *“Unë duhet të jem vetvetja, ai/ajo që jam”*. Kjo është e vërtetë, por unë duhet të jem më i miri ose më e mira e asaj që jam për hir të Krishtit. *“Ai/ajo që jam”* kryqëzohet tek vetja, por është e gjallë tek Ai. Si bashkëshortja e një shërbestari, ty të është dhënë mundësia e artë për të ndikuar tek njerëzit rreth e rrotull teje me anë të mundësive që të janë dhënë ty nga Perëndia. Njerëzit vështrojnë mënyrën se si reagon ndaj situatave të vështira. Ata shohin se si sillesh me bashkëshortin dhe me fëmijët e tu. Ata shohin se si sillesh me njerëzit e tjerë. Thuhet shpeshherë që bashkëshortja e një shërbestari jeton në një akvarium prej xhami. Çfarë mundësie! Nëse kjo ka lidhje me ty, atëherë mos e lejo të kthehet në një problem. Në fakt, të gjithë besimtarët duhet të jetojnë

në këtë mënyrë. Këto nuk janë fjalët e mia, por janë këshilla që na janë dhënë nga fjala e Perëndisë. Tek Filipianëve 2:12 thuhet: *“[Punoni] për shpëtimin tuaj me frikë e me dridhje”*. Tek Filipianëve 2:5 thuhet: *“Kini në veten tuaj po atë mendje që ishte edhe në Jezu Krishtin”*. Sigurisht, të gjithë biem dakord që përpjekjet tona më të mira, në vetvete nuk janë të mjaftueshme. Por tek Filipianëve 2:13 thuhet: *“sepse Perëndia është ai që vepron në ju edhe vullnetin edhe veprimtarinë, sipas pëlqimit të tij”*. Ndërsa marrim përsipër detyrën për t'i pëlqyer Atij dhe për të qenë një shembull për Të, duhet të mbajmë mend se Perëndia është duke siguruar edhe dëshirën, edhe forcën për t'i përmbushur këto.

Shumë herë, madje goxha shpesh, betejat me të cilat përballemi nuk na vijnë në formë njerëzore, por mund të sulmojnë mendjen dhe frymën tonë. Mund ta keni dëgjuar edhe më parë të thuhet se mendja është këndi i lojërave i djallit. Në realitet, betejat frymërore, shpesh ato me pasoja të mëdha, mund të jenë personale dhe relativisht të vogla. Prandaj, si gra të Perëndisë, le të marrim parasysh disa nga betejat me të cilat përballemi ndërsa “ruajmë vreshtin”.





Cilat janë disa nga “dhelprat e vogla” që mund të hyjnë në jetët tona? Shumë herë ato nuk i shikon kush, duken të vogla dhe pa ndonjë pasojë deri në çastin kur të jetë bërë dëmi i vërtetë. Mbani mend, dhelprat e vogla bëhen të mëdha. Dhelprat e vogla në jetët tona mund të mos vihen re në fillim ose mund të duken të parrezikshme, por nëse nuk ballafaqohen dhe nëse lejohen të rriten, ato do të bëhen më të forta dhe si përfundim mund të na shkatërrojnë. Mëkatet e vogla nuk duken edhe aq të rrezikshme dhe kjo është pjesa më e madhe e rrezikut të tyre. Është vetëm një dhelpër e vogël, apo jo, ç’dëm mund të më bëjë?

Një nga “dhelprat” në jetën tonë mund të jetë **egoizmi**. Se në fund të fundit, jam gruaja e pastorit. Duhet të marr vëmendje të veçantë. Gjithmonë gjërat duhet të bëhen siç dua dhe siç them unë. Kjo madje mund të bëjë të ndjesh keqardhje për vetveten – “oh, e shkreta unë”. Të gjithë përfitojnë prej meje, askush nuk i vë re gjithë ato gjërat që bëj unë. Por, çfarë na mëson Jezusi? Shkrimi na tregon se Zoti nuk e kënaqi veten e tij. Në fakt, e gjithë jeta e Tij ishte një jetë plot bujari. Ne e japim veten tonë në shërbim ndaj Tij. Kur e kuptojmë vërtet se për kë po

punojmë, atëherë bëhet më e lehtë që të mos mendojmë se çfarë përfitojmë, por që më tepër të mendojmë se çfarë mund të bëjmë për t’i pëlqyer Atij. Të menduarit më shumë për të tjerët se sa për veten, na lejon të arrijmë të tjerët gjatë shërbesës sonë ndaj Zotit. Kur të tjerët shohin që ti e jep veten në shërbim ndaj Mjeshtrit, edhe ata inkurajohen që të bëjnë të njëjtën gjë.

Një tjetër “dhelpër e vogël” që mund të hyjë tinëz në jetën tonë është **temperamenti**. Një shpërthim i vogël inati. Në fund të fundit, ishe e provokuar, e irrituar, e lodhur dhe më në fund iu dorëzove zemërimit që po të vlonte përbrenda. Mos më keqkuptoni; nuk po gjuaj me gurë asnjërin, sepse të gjithë kemi pasur në kohë të ndryshme beteja tona me temperamentin. Gjërat duket se po shkojnë mirë dhe pastaj, si një stuhi e papritur, një frymë gëlon brenda nesh. Ndoshta egoja na pengoi dhe u ndiem të sulmuar. Reaguam duke folur me zemërim ose duke treguar temperamentin tonë duke qëndruar të ngrysur. Kjo dhelpër, nëse e lejojmë të qëndrojë, do ta përllajë frytin e Frymës që është në jetën tonë. Krejt papritur, bashkë me këto, vjen edhe *xhelozia*, e cila sapo ka hyrë dhe nuk vihet shumë re në fillim,



Dhelpra, megjithëse mund të jetë e vogël, prapë se prapë është një dhelpër e vërtetë!

derisa personi konsumohet me këtë frymë. Kjo është një frymë shumë shkatërrimtare.

- ✿ Xhelozia mund ta bëjë dikë që të keqtrajtojë të tjerët.
- ✿ Xhelozia mund të bëjë ty që të kesh dyshime për të tjerët.
- ✿ Xhelozia mund të bëjë ty që t'i gjykosht shtrembër të tjerët.

Rezultatet e brendshme të xhelozisë mund të rriten, derisa individi të bëhet shumë i trishtuar dhe i mjeruar. Vetëkuptohet që “vreshti” po konsumohet. Kjo xhelozia mund të jetë ndaj një anëtareje tjetër të kishës. Mund të jetë gruaja e një pastori tjetër. Ose madje mund të jetë edhe ndaj bashkëshortit tënd. Mund të jetë xhelozia për kohën që ai shpenzon me të tjerët, për kohën që i kushton shërbesës. Pastaj, nuk e kupton ai që edhe unë jam anëtare e bashkësisë së tij dhe kam nevojë për vëmendjen e tij? E them përsëri, fryma e xhelozisë mund të jetë kaq shkatërrimtare, jo vetëm për personin, por gjithashtu edhe për martesën. Prandaj, zonja të dashura, jini të kujdesshme dhe ruhuni nga kjo dhëlpër, e cila mund të jetë shumë shkatërrimtare. Fjala xhelozia shpesh përdoret si një sinonim për fjalën *zili*. Rakela, gruaja e Jakobit, e cila nuk kishte fëmijë, kishte zili Lean, motrën e saj, e cila kishte lindur katër djem (Zanafilla 29-30). Vëllezërit e Jozefit e kishin zili atë, sepse babai i tyre i kushtoi atij më shumë vëmendje (Zanafilla 37). Drejtuesit fetarë në Izrael e kishin zili Krishtin, sepse njerëzit ndiqnin Atë dhe po iu zbehej ndikimi që kishin mbi popullin (madje edhe Pilati e kishte vënë re zilinë e tyre – Mateu 27:18; Marku 15:10).

Ka kaq shumë dhëlpër që mund të na i prishin vreshtat e jetës sonë. Prandaj, përpara se të vazhdojmë, le të ndalojmë për një moment dhe të falënderojmë Perëndinë tonë të mrekullueshëm të cilit i shërbejmë. Ne kemi sigurinë prej Tij se nuk jemi të vetëm në këtë betejë. Fryma e Tij e mrekullueshme është me ne, që të na ruajë dhe të na mbrojë dhe të na çelë sytë se dhelprat janë rreth e rrotull duke kërkuar një vrimë për të hyrë vjedhurazi. Por, lavdi Zotit që më i madh është Ai që është brenda meje. Kuptoj që nuk më duhet ta mbroj vreshtin tim e vetme.

Më falni, por m'u duk me rëndësi që të ndalesha për një moment dhe të kujtoja se Perëndia është në anën tonë, që të mos shkurajohemi shumë kur përballemi me lukuninë e dhelprave që presin në hije një mundësi për të rrëshqitur brenda jetëve tona.

Kur përdora fjalën “më falni” më sipër, më erdhi ndërmend një tjetër dhëlpër me të cilën mund të përballemi dhe ajo është dhelpra e **mosfaljes**. I kam vëzhguar mirë individët të cilët kanë përjetuar vështirësi të mëdha. Ose atë personin që është keqtrajtuar nga dikush me të cilin ka shpenzuar një kohë mjaft të gjatë, qoftë në lutje, qoftë personalisht. Është e dhimbshme, për të thënë të drejtën. Ose, mund të jetë një shoqe që ka shkelur një konfidencë të një rëndësie të madhe dhe kjo gjë ishte shumë e dhimbshme. Madje mund të jetë falja e bashkëshortit, pasi ai tha diçka ose veproi në një mënyrë që ishte shumë lënduese për ty. E vërteta është që nëse nuk do të qe bërë asnjë gabim ose lëndim, nuk do të kishte nevojë për falje. Kur mendojmë rreth faljes, gjëja e parë qëna vjen në mendje është vetë nevoja jonë për falje. Krishti ishte shumë besnik sa që na fali nga gabimet tona të shumta dhe vazhdon ta bëjë këtë, kur vijmë tek Ai dhe kërkojmë falje. Ai është shembulli kryesor i faljes. Nëse Ai mund të më falë, kush jam unë për të mos qenë e gatshme që t'i fal të tjerët. Në fakt, fjala e Tij thotë se do të falemi siç falim të tjerët.

Teksa po flas për faljen, më vjen ndërmend një tjetër dhëlpër, shumë e vërtetë dhe shumë dinake që hyn tinëz në jetët tona. Më lejoni të jem pak më personale në këtë moment dhe të ndaj pak nga përvoja ime. Kishim vetëm një fëmijë, një thesar të vogël me emrin Mishela. Në moshën nëntë vjeçare, Mishela u sëmur rëndë me një çrregullim shumë të rrallë gjaku. Ajo jetoi edhe për gjashtëmbëdhjetë muaj para se të kalonte një shkallë më sipër në praninë e Zotit. Ndoshta në një kohë tjetër do të ndaj disa nga gjërat e mrekullueshme që Perëndia bëri për të gjatë kohës së sëmundjes, si dhe për ato që bëri për ne ndërsa po merrnim shërim emocional. Tani po tregohem shumë e hapur dhe e singertë me ju. Gjatë asaj kohe burri im ishte pastor i një kishë të madhe me një bashkësi fantastike. Ata treguan dashuri të pastër dhe mbështetje me dashamirësi, por humbja më dhembte shumë thellë. Më kujtohet ajo mbrëmje në kishë kur bashkësia po këndonte këngën: “Perëndia është aq i mirë”. Papritur, kuptova se nuk mund ta këndoja dot këtë këngë. Po ju rrëfej me zemër të hapur se kjo gjë më trembte. Unë jam rritur në kishë, kam qenë vajzë pastori dhe tani jam gruaja e pastorit. E kam dashur dhe i kam shërbyer Perëndisë gjithë jetën time, por tani nuk mund të këndoja dot: “Perëndia është aq i mirë”. Duke menduar faktin që unë jam një person që e kishte dashur dhe i kishte besuar Jezusit, kjo më trembte.

Jo shumë kohë më parë, e gjithë familja jonë ishte mbledhur rreth tavolinës për një darkë të veçantë dhe ishte shumë e dukshme që vendi i Mishelës ishte bosh. Unë kam vetëm një motër dhe ajo ka dy fëmijë. Pra, edhe kur ishim të gjithë bashkë bëheshim vetëm nëntë vetë. Tani ishim vetëm tetë. Diçka filloi të ndodhte me mua atë natë. Kuptova që gjithë të afërmit e mi, prindërit e mi, madje edhe motra ime kishin të paktën nga dy fëmijë, kurse ne kishim vetëm një. Tani edhe ajo një nuk ishte më me ne, kurse ata i kishin të gjithë fëmijët e tyre. Mos më keqkuptoni, unë isha shumë mirënjohëse që ata i kishin fëmijët e tyre, por pyetja: "Pse m'u mor mua e vetmja që kisha?", filloi të mos më ndahej. Një ditë, kur të qëndroj në praninë e Tij, do ta kem përgjigjen, por tani për tani më duhet t'i besoj Atij. Ai është i mirë dhe më do. Por atë natë, **zemërimi i hidhur** filloi të hynte tinëz në cepat e zemrës sime. Me anë të hirit të Zotit tonë mahnitës kuptova që nuk më duhej të bëja ndonjë mëkat "të madh", mjaftonte të lejoja dhelpren e vogël të zemërimit të qëndronte në zemrën time dhe para se ta kuptoja se çfarë po ndodhte, i gjithë kopshti i zemrës sime do të shkatërrohej. Prej andej vetëm sa do të vazhdonte të bëhej më keq, por gjithçka do të kishte filluar thellë brenda fshehtësisë së zemrës sime.

Fatmirësisht, për shkak të Perëndisë tim të mëshirshëm, mund t'ju çoj sot në të njëjtin vend në kishë ku qëndrova në gjunjë dhe kundërshtova armikun që po përpiquej të më shkatërronte. Nga ajo kohë e në vazhdim nuk kam pasur më zemërim të hidhur. Natyrisht ka pasur, për shkak të humbjes sonë, momente shumë të dhimbshme. Dëshira për të pasur mundësinë ta përqafoj edhe njëherë në krahët e mia Mishelën tonë të çmuar vazhdon edhe sot e kësaj dite, por nuk kam zemërim në zemër. Perëndisë i qoftë e gjithë lavdia! A nuk jemi të gëzuar për premtimet e Zotit?! Ai na ka përgatitur një vend të përjetshëm. Një ditë do të jemi përsëri të gjithë bashkë. Lavdi emrit të Tij!

Përsëri faqet e revistës na e kufizojnë kohën tonë së bashku. Më lejoni t'ju sugjeroj disa gjëra që mund t'ju ndihmojnë që t'i mbani larg dhelptrat e vogla për të mos ju shkatërruar ose për të mos bërë ndonjë dëm të madh në jetët tuaja.

1. Mbani një jetë të disiplinuar përkushtimi të përditshëm ndaj Perëndisë.
2. Jini të hapura ndaj shërbesës personale të Frymës së Shenjtë
3. Adhurojeni shpesh Perëndinë privatisht.
4. Vëzhgoni mendimet tuaja.
5. Merrni autoritet mbi sulmet e satanit. Ndërsa e dalloni armikun, përdorni Fjalën e Perëndisë për t'i mposhtur të gjitha dredhitë e satanit.

Bekime për ju, kolege të veçanta gjatë këtyre të korrave të kohëve të fundit.

Mos harroni që të ruheni mirë nga "dhelptrat e vogla".



MARCIA LEDNICKÝ, është një folëse e shpeshtë nëpër seminare dhe konferenca për femra. Ajo ka një aftësi unike për t'i lidhur sfidat e jetës së përditshme me të vërtetat e Shkrimit. Shërbesa e saj e të folurit në publik rritet me anë të talentit të saj vokal të jashtëzakonshëm përmes të cilit ajo komunikon dhe transmeton dashurinë e Krishtit.

"Qëndroni të Fortë"

TEKSTI: 1 Korintasve 15

Nga: KURT PLAGENHOEF

HYRJE

Vëllezër dhe motra, jemi në luftë. Është një luftë e madhe për ungjillin e Krishtit dhe besimin tonë. Edhe Pali ka luftuar shumë. Ai ka hasur shumë vështirësi dhe kundërshtime në shërbesën e tij siç lexojmë në Letrën e Dytë Drejtuar Korintasve (2 Kor. 4:8-12; 6:3-10; 11:21-33). Por ai qëndroi i fortë në besim dhe ndaj thirrjes. Nëse ju do të qëndroni të fortë në ungjillin e Krishtit, Perëndia do t'ju japë fitore ndaj çdo sulmi të armikut. Qëndroni të fortë

I. BESIMI JUAJ NUK ËSHTË I KOTË (v.1-2)

1. Ju po qëndroni në ungjillin e Krishtit (v. 1)
2. Ju jeni shpëtuar me anë të ungjillit, nëse do ta mbani Fjalën (v. 2)

II. THIRRJA JUAJ NUK ËSHTË E KOTË (v. 9-10)

1. Duhet të dini cila është thirrja juaj (v. 9)
2. Duhet të besoni në hirin e Perëndisë për të plotësuar thirrjen tuaj (v. 10)

PËRFUNDIM:

Qëndroni të fortë sepse besimi, thirrja, predikimi dhe mudi juaj nuk janë të kotë! Meqenëse Krishti është ringjallur, atëherë ungjilli është i vërtetë, ne do të shpëtohem, e kemi fitoren dhe mund të qëndrojmë të fortë deri në fund. Qëndroni të patundur tek Krishti. Qëndroni të patundur tek ungjilli dhe doktrina e shëndoshë. Qëndroni të patundur në përlujtë ndaj udhëheqjes së dhënë nga Perëndia. Nëse ju do të qëndroni të fortë ndaj ungjillit të Krishtit, Perëndia do t'ju japë fitore mbi çdo sulm të armikut. Tregohuni besnikë dhe ai do t'ju bëjë të frytshëm.

III. PREDIKIMI JUAJ NUK ËSHTË I KOTË (v. 14)

1. Meqenëse Krishti është ringjallur, predikimi ynë nuk është i kotë.
2. Perëndia zgjodhi që ta përhapë ungjillin "nëpërmjet marrëzisë së predikimit" (1 Kor. 1:21) — jo marrëzisë së metodës, por asaj që në dukje shihet si marrëzi e mesazhit.
3. Te Kapitulli 1, vargu 18, ai thotë: "Sepse mesazhi i kryqit është marrëzi për ata që humbin, por për ne që shpëtohem është fuqia e Perëndisë....(pra) ne predikojmë Krishtin të kryqëzuar (1:23)... Krishtin, fuqia e Perëndisë dhe dituria e Perëndisë (1:24)...Krishti...drejtësia, shenjtëria, dhe shpengimi ynë (1:30)".

IV. MUNDI JUAJ NUK ËSHTË I KOTË (v. 58)

1. Qëndroni të fortë e të patundur (v. 58a)
2. Duke tepruar përherë në veprën e Zotit (v. 58b)

Së shpejti...

KONFERENCA PËR MISIONIN

**Kolegji Teologjik Ungjillor
17-19 MARS, 2015
nga 10:45-12:00**

**Ejani bashkohuni me studentët e KTU-së për
tre ditë të veçanta për të kapur vizionin e
Perëndisë për botën.**

Të gjithë janë të mirëpritur!

KONFERENCA E TË RINJVE TË BALLKANIT

**Organizuar nga KPAPSH
20-22 MARS, 2015**

**Të rinj nga Italia, Anglia dhe kombet e
Ballkanit do të mblidhen së bashku në
Shqipëri për një kohë shërbese të mbushur me
fuqi e të fokusuar mbi ungjillizimin e Ballkanit
përmes lutjes, mbështetjes dhe partneritetit.**

***Të gjithë të rinjtë e KPAPSH-së janë të ftuar
të marrin pjesë.***

**Shënoni këto data në kalendarët tuaj, dhe i
inkurajoni të rinjtë e kishës suaj që të marrin
pjesë. Është një konferencë që nuk duhet
humbur!**

